USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

MINISTRIA E SHENDETESISE
SPITALI RAJONAL KORÇË

SHËRBIMI PËR MIRËMBAJTJEN E MJEDISIT

PRAKTIKA TË PASTRIMIT DHE DEZINFEKTIMIT

MANUAL PERDORIMI

Maj 2013

Ky publikim u mundësua nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. U përgatit nga Spitali Rajonal Korçë nëpërmjet Projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi".

Citim i rekomanduar: Spitali Rajonal Korçë nëpërmjet Projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" Maj, 2013. Shërbimi për Mirëmbajtjen e Mjedisit: Praktika të Pastrimit dhe Dezenfektimit: Manual Përdorimi.

Projekti i USAID "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" menaxhohet nga Abt Associates nën kontratën 182-C-00-10-00104-00

SHËRBIMI PËR MIRËMBAJTJEN E MJEDISIT

PRAKTIKA TË PASTRIMIT DHE DEZINFEKTIMIT

MANUAL PËRDORIMI

REFUZIM
Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara

PËRMBAJTJA

FALENDERIME 7

PARATHËNIE 9

1. PARIME TË PËRGJITHSHME 10

2. BURIMET PËR PASTRIMIN E AMBIENTIT (PA) 10

3. SHPESHTËSIA E PASTRIMIT RUTINË 11

3.1 NËSE SIPËRFAQET PREKEN MË SHUME APO MË PAK ME DUAR. 11

3.2 NDJESHMËRIA E PACIENTËVE NDAJ INFEKSIONEVE TË AMBIENTIT 11

3.3 PROBABILITETI I KONTAMINIMIT TË OBJEKTEVE DHE SIPËRFAQEVE NË AMBIENTET E KUJDESIT PËR PACIENTIN. 11

3.3.1 ZONAT SHUMË TË KONTAMINUARA 11

3.3.2 ZONA ME KONTAMINIM TË MODERUAR 11

3.3.3 ZONAT ME KONTAMINIM TË LEHTË 12

4. PRAKTIKA RUTINË TË PASTRIMIT DHE DEZINFEKTIMIT NË SPITAL 13

4.1 PRAKTIKA TË PËRGJITHSHME PASTRIMI 13

4.2 METODAT E PASTRIMIT 14

4.2.1 PASTRIMI I DHOMËS SË PACIENTIT 14

4.2.2 ZONAT STERILE/KIRURGJIKALE 18

4.2.3 PROCEDURË PËR PASTRIMIN E AMBIENTEVE TË LABORATORIT KLINIK 22

4.2.4 PROCEDURA E PASTRIMIT TË SALLAVE TË LINDJES NË MATERNITET 23

4.3 PASTRIMI DHE DEZINFEKTIMI I AMBIENTEVE TË PACIENTËVE NË PËRKUJDESJE TË VEÇANTË 25

5. PASTRIMI I NJOLLAVE TË GJAKUT DHE SUBSTANCAVE TË TJERA TRUPORE 27

6. PROCEDURA PËR PASTRIMIN E MAKINËS SË AMBULANCËS 28

7. PROTOKOLL MBI HIGJIENËN OPTIMALE TË DUARVE 29

8. DEZINFEKTIMI DHE STERILIZIMI 31

8.1 DEZINFEKTIMI 31

8.2 STERILIZIMI 33

9. MENAXHIMI I TESHAVE TË NDOTURA 34

10. MENAXHIMI I MBETURINAVE 35

11. LISTËKONTROLLET PËR PASTRIMIN MJEDISOR DHE INSTRUMENTAT E MONITORIMIT 37

11.1 LISTËKONTROLLI PASTRIMI #1: PASTRIM I PËRDITSHËM RUTINË I DHOMËS SË PACIENTIT: 38

11.2 LISTËKONTROLLI PASTRIMI #2: PASTRIMI I DHOMËS SË PACIENTIT NË PËRKUJDESJE TË VEÇANTË PËR SËMUNDJE INFEKTIVE NGJITËSE 39

12. INSTRUMENTAT E MONITORIMIT 41

13. STRUKTURA E SEKTORIT TE SHERBIMEVE MJEDISORE DHE PERSHKRIMET E PUNES. 43

13.1 STRUKTURA DHE DETYRAT E SEKTORIT TE SHERBIMEVE MJEDISORE. 43

13.1.1 STRUKTURA 43
13.1.2 DETYRAT E SEKTORIT TE SHERBIMEVE MJEDISORE. 43

FALENDERIME

Spitali Rajonal Korçë falenderon Ministrinë e Shëndetësisë dhe projektin "Mbështetje e Reformës në Shëndetësi" financuar nga USAID për ndihmesën e dhënë në përgatitjen e Standarteve të Higjienës për spitalin tonë.

Falenderohen gjithashtu gjithë anëtarët e Grupit të Punës për Shërbimet Mjedisore: Dr. Ornela Ruço, Dr. Merita Kroi, Dr. Edlira Bode dhe Znj. Rezarta Korançe, Znj. Mirela Dhëmbi, që punuan për përgatitjen e këtij dokumenti kaq të rëndesishëm për mbarëvajtjen e punës së spitalit, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe rritjes së kënaqësisë së stafit dhe pacientëve.

PARATHËNIE

Praktika të mira të pastrimit të ambienteve janë thelbësore për zvogëlimin e rrezikut të transmetimit të sëmundjeve infektive. Kjo do të kontribuojë në një kulturë të sigurisë duke siguruar një atmosferë të pastërtisë së përgjithshme dhe të rregullit të mirë. Të gjithë ata që punojnë në mjediset spitalore kanë të drejtën të mendojnë se në ambientin ku ata punojnë rreziqet kontrollohen në mënyrën e duhur, dhe sa herë është e nevojshme ata marrin informacion për t'i aftësuar të mbrojnë veten e tyre dhe të tjerët nga sëmundjet.

Pastrimi në një mjedis spitalor duhet të kryhet mbi baza të përditshme dhe të qëndrueshme për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të pastër. Mbajtja e një mjedisi të kujdesit për pacientin të pastër dhe të sigurt është komponenti më i rëndësishëm i parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve. Përveç kësaj, ka shumë pak të dhëna të cilësisë së pranueshme për tu përdorur si bazë për rregulloren e mirëmbajtjes së higjienës mjedisore në spital. Standartet aktuale për vlerësimin e higjienës në spital rekomandojnë përdorimin si një kriter performance të pastërtisë së dallueshme me sy, megjithë faktin se vetëm vlerësimi vizual nuk mund të jetë një indikator i përshtatshëm i matjes së efikasitetit të pastërtisë.

Thjesht sepse 'duket' pastër nuk do të thotë që nuk është e kontaminuar me baktere apo viruse.

1. PARIME TË PËRGJITHSHME

Praktikat më të mira të pastrimit janë formuluar për të plotësuar nevojat e mëposhtme:

- fokusi parësor do të mbetet mbrojtja e klientit/pacientit, stafit dhe vizitorëve praktikat do të ndihmojnë në minimizimin e përhapjes së infeksioneve
- praktikat do të jenë të kuptueshme dhe të realizueshme
- praktikat do të rishikohen shpesh për të qene aktuale me ndryshimet në ambientin e kujdesit shëndetësor spitalor

2. BURIMET PËR PASTRIMIN E AMBIENTIT (PA)

Spitali do të sigurojë burimet e duhura për PA që përfshijnë:

Procedura të shkruara për pastrimin dhe dezinfektimin e zonave të pacientit dhe pajisjeve që përfshijnë:

- Përgjegjësi të përcaktuara për çështje dhe zona të veçanta
- Burime njerëzore të mjaftueshme për të lejuar një pastrim dhe dezinfektim të plotë dhe në kohë
- Procedura për pastrimin dhe dezinfektimin e përditshëm për daljet apo transferimet nga spitali
- Standardet dhe shpeshtësia e pastrimit dhe dezinfektimit
- Përparësitë për pastrim që ju jepet zonave të kujdesit për pacientin krahasuar me zonat administrative dhe ato publike
- Procedura për pastrimin e zonave të veçanta si dhomat e pacientëve me sëmundje infektive ngjitëse
- Edukim në vazhdim për stafin e pastrimit
- Monitorim të pastërtisë mjedisore dhe raportim të rezultateve në mënyrën e duhur për tu bërë pjesë e rishikimit të performancës së punonjësit
- Mbikqyrje të stafit të pastrimit nga ana e personit/personave që janë të trajnuar dhe kanë njohuri për standartet dhe praktikat e pastrimit
- Rishikim të shpeshtë të procedurave

3. SHPESHTËSIA E PASTRIMIT RUTINË

Shpeshtësia e pastrimit dhe dezinfektimit të objekteve apo sipërfaqeve në një zonë apo repart të caktuar varet nga:

3.1 NËSE SIPËRFAQET PREKEN MË SHUME APO MË PAK ME DUAR.

Të gjithë sipërfaqet në ambientet e kujdesit për pacientin kanë potencialin për të mirëpritur mikroorganizma patogjene. Potenciali i ekspozimit ndaj patogjeneve bazohet në shpeshtësinë e kontaktit me një sipërfaqe të kontaminuar dhe lloji i aktivitetit që kryhet.

Sipërfaqet që preken më shpesh me duar (dorezat e derës së dhomës së pacientit, të banjos, hapësirat e mureve rreth banjos, çelësat e dritave, butonat e ashensorit, monitorët, etj) do të kërkojnë një regjim pastrimi dhe dezinfektimi më të shpeshtë. Pastrimi dhe dezinfektimi i këtyre sipërfaqeve do të bëhet të paktën dy herë në turn dhe më shpesh nëse rreziku i kontaminimit të ambientit është i lartë (psh reparti i terapisë intensive).

Në shumicën e rasteve, sipërfaqet e ambienteve do të pastrohen në mënyrën e duhur me ujë dhe sapun ose detergjent/dezinfektant në varesi të llojit të sipërfaqes, tipit dhe shkallës së kontaminimit.

Sipërfaqet që preken më pak me duar përfshijnë dyshemetë, muret, tavanet, pasqyrat dhe parvazet e dritareve. Këto sipërfaqe kërkojnë një pastrim periodik (por jo domosdoshmërisht përditë, me përjashtim të dyshemeve që lahen përditë), sa herë kanë ndotje apo njolla, dhe sa herë një pacient del nga spitali apo transferohet.

3.2 NDJESHMËRIA E PACIENTËVE NDAJ INFEKSIONEVE TË AMBIENTIT

Pacientët më të ndjeshëm janë ata që janë më të ndjeshëm ndaj infeksionit për shkak të kondicionit mjekësor ose mungesës së imunitetit. Ato përfshijnë pacientët imunodepresive (onkologji, kemoterapi), neonatet (inkubatorët) dhe ata me djegie të rënda (kirurgji).

Dhomat e këtyre pacientëve duhet të pastrohen pas çdo rasti/procedure dhe të paktën dy herë në turn. Pastrim shtesë duhet të kryhet nëse kërkohet.

Për qëllime të pastrimit, të gjithë individët dhe zonat e tjera klasifikohen si më pak të ndjeshme.

3.3 PROBABILITETI I KONTAMINIMIT TË OBJEKTEVE DHE SIPËRFAQEVE NË AMBIENTET E KUJDESIT PËR PACIENTIN.

Lloji i aktivitetit që kryhet në zonë dhe rreziku i infeksionit që lidhet me të (psh zonat e kujdesit kritik kundrejt dhomës së mbledhjeve)

Probabiliteti që një sipërfaqe, pajisje apo zonë kujdesi do të kontaminohet varet nga aktiviteti që kryhet në atë zonë, tipi i patogjenëve të përfshirë dhe ngarkesa mikrobike. Zonat që janë të ndotura me gjak ose lëngje të tjera trupore do të kërkojnë një pastrim dhe dezinfektim më të shpeshtë se zonat e tjera që janë pak ose aspak të ndotura (korridoret, zyrat, etj).

3.3.1 ZONAT SHUMË TË KONTAMINUARA

Një zonë konsiderohet shumë e kontaminuar nëse sipërfaqet dhe/ose pajisjet e saj jane të ekspozuara ndaj sasive të mëdha të gjakut apo lëngjeve të trupit (sallat e lindjes, dhoma e autopsisë, reparti i djegieve, reparti i Urgjencës, banja e pacientit).

Të gjitha këto zona apo sipërfaqe duhet të pastrohen pas çdo procedure/rasti dhe të paktën dy herë në turn. Mund të kërkohet dhe pastrim shtesë.

3.3.2 ZONA ME KONTAMINIM TË MODERUAR

Një zonë konsiderohet me kontaminim të moderuar nëse sipërfaqet dhe/ose pajisjet janë të kontaminuara me gjak ose lëngje të tjerë trupore si pjesë e aktivitetit të përditshëm (psh dhoma e

pacientit, banja e pacientit) dhe substancat kontaminuese hiqen dhe largohen (psh çarçafet e lagur). Të gjithë dhomat dhe banjot e pacientëve duhet të konsiderohen relativisht të kontaminuara.

Zonat e mësipërme duhet të pastrohen të paktën një herë në turn. Mund të kryhet dhe pastrim shtesë nëse janë shumë të ndotura.

3.3.3 ZONAT ME KONTAMINIM TË LEHTË

Një zonë konsiderohet të jetë pak e kontaminuar nëse sipërfaqet e saj nuk janë të ekspozuara ndaj gjakut, lëngjeve të trupit apo objekteve të tjera që kanë qënë në kontakt me gjakun apo lëngjet e trupit (korridoret, zyrat, etj). Këto zona pastrohen sipas një programi të caktuar.

Duke përdorur këto kritere, çdo zonë apo repart në spital do të përcaktojë shpeshtësinë me të cilën do të pastrohen ambientet e tij.

4. PRAKTIKA RUTINË TË PASTRIMIT DHE DEZINFEKTIMIT NË SPITAL

4.1 PRAKTIKA TË PËRGJITHSHME PASTRIMI

Spitali si vend i ofrimit të kujdesit ndaj pacientit dhe të kryerjes së funksioneve të tjera administrative kërkon që zonat që ofrojnë kujdes për pacientin të pastrohen duke mbajtur parasysh që përveç pastrimit të zakonshëm të kryhet më pas dhe dezinfektimi i të njëjtave zonave me një dezinfektant spitalor bazuar në rrezikun e pacientëve si dhe kërkohet të kryhet auditim dhe monitorim periodik i praktikave të pastrimit nga supervizori i stafit të pastrimit (psh përgjegjësia e materialit apo kryeinfermieri/a) menjëherë pas përfundimit të procedurës së pastrimit.

Çelësi për një pastrim dhe dezinfektim të sipërfaqeve të ambientit është përdorimi i fërkimit për të larguar mikroorganizmat dhe pluhurat. Sipërfaqet duhet të pastrohen nga mbeturinat e dukshme përpara se të dezinfektohen, sepse materialet organike mund ta ç'aktivizojnë dezinfektantin.

Praktikat e përgjithshme të pastrimit që duhet të ndiqen në spital janë si më poshtë:

Përpara pastrimit:

- Duhet të kontrollohen udhëzimet e përgjegjëses së materialit apo kryeinfermieres së repartit nëse ka nevojë për përkujdesje të veçanta. Duhet të ndiqen udhëzimet sipas specifikës.
- Vendoset rregull në dhomë përpara pastrimit.
- Duhet të ndiqen me kujdes udhëzimet e prodhuesit për hollimin dhe kohën e kontaktit me solucionet e pastrimit dhe dezinfektimit.
- Duhet të bëhen gati materialet për pastrim përpara se të hyhet në dhomën që do të pastrohet.
- Pastroni duart kur hyni në dhomë.

Gjatë pastrimit:

- Duhet të pastrohet nga zonat më pak të ndotura (më pak të prekura me duar) drejt zonave më shumë të ndotura (që preken më shumë me duar) dhe nga lart poshtë.
- Të hiqen mbetjet e shumta përpara pastrimit dhe dezinfektimit me leckë të thatë përpara aplikimit me leckë të lagur/njomë.
- Të bëhet kujdes gjatë pastrimit me leckë të thatë për të parandaluar përhapjen e pluhurit që mund të përmbajë mikroorganizma.
- Mos e shkundni asnjëherë shtupën.
- Mos e 'zhysni dy herë' leckën.
- Ndërroni shpesh leckat e pastrimit dhe shtupën.
- Ndërroni solucionet e pastrimit sipas udhëzimeve të prodhuesit. Ndërrojini më shpesh solucionet në zonat që janë shumë të kontaminuara, në zonat që janë dukshëm të ndotura dhe menjëherë pasi keni pastruar njollat me gjak dhe lëngje trupore.
- Bëni kujdes për aget apo objekte të tjera të mprehta. Mblidhni objektet e mprehta duke përdorur një pajisje mekanike (mos i kapni me duar) dhe vendosini në kontenierin e të mprehtave. Raportoni incidentin tek supervizori juaj.
- Mblidhni mbeturinat, mbajeni qesen plastike duke e kapur nga koka (mos i shtypni asnjëherë qeset me duar).
- Lani duart përpara se të largoheni nga dhoma.

Pas pastrimit:

- Mos i mbingarkoni dhomat.
- Veglat e përdorura për pastrim dhe dezinfektim duhet të pastrohen dhe thahen pas përdorimit.
- Shtupat duhet të lahen përditë. Përpara ripërdorimit të tyre të gjithë shtupat duhet të thahen plotësisht.
- Pastroni përditë karrocat e pastrimit dhe karrocat e transportit të mbetjeve.

4.2 METODAT E PASTRIMIT

4.2.1 PASTRIMI I DHOMËS SË PACIENTIT

PASTRIM RUTINË I PËRDITSHËM I DHOMËS.

Pastrimi i dhomave të pacientëve duhet të ndjekë një rregull metodik dhe të planifikuar që përfshin elementët e mëposhtëm:

- Vlerësimin – ecni përgjatë dhomës për të përcaktuar çfarë ka nevojë të zëvendësohet (psh letër tualeti, letër duarsh, sapun, xhel me alkool, qeset e mbeturinave, koshi i mbeturinave) dhe nëse ka nevojë për ndonjë material të veçantë, kjo mund të bëhet përpara ose gjatë procesit të pastrimit.
- Përgatitja e pajisjeve – bëni gati të gjithë pajisjet e duhura përpara se të filloni pastrimin e dhomës
- Higjiena e duarve – kryeni higjienën e duarve kur hyni në dhomë dhe përpara vendosjes së dorezave
- Pastrimi dhe dezinfektimi – punoni nga zonat më të pastra dhe më lart drejt zonave më të ndotura dhe më poshtë dhomës
- Largimi i mbetjeve – mblidhni mbeturinat
- Hiqni dorezat dhe kryeni higjienën e duarve përpara largimit nga dhoma ose nga hapësira e shtratit

PROCEDURA E PASTRIMIT RUTINË TË DHOMËS SË PACIENTIT

- Vlerësimi
  - Kontrolloni për shenja kujdesi të veçanta (shiko procedurat e pastrimit për kujdes të veçantë)
  - Kaloni përmes dhomës për të përcaktuar çfarë ka nevojë të zëvendësohet (letra e tualetit, peshqiri, sapuni), të boshatiset koshi i mbeturinave, ose nëse kërkohet ndonjë material tjetër; kjo mund të bëhet përpara ose gjatë procesit të pastrimit
- Përgatitni pajisjet
  - Sigurohuni që ka furnizim të teshave të pastra
  - Përgatitni solucionin e dezinfektantit sipas udhëzimeve të prodhuesit
- Pastroni duart duke i larë me ujë dhe sapun ose xhel me përmbajtje alkooli dhe vishni dorezat
- Pastroni dhomën duke punuar nga zona e pastër e dhomës drejt zonës së ndotur dhe nga lart poshtë;
  - Ndërroni leckën e pastrimit pas pastrimit të zonave të ndotura si tualeti
  - Nëse ka më shumë se një shtrat në dhomë, përdorni lecka të pastra për çdo hapësirë shtrati dhe përfundoni pastrimin me një hapësirë shtrati përpara se të kaloni tek tjetra
  - Filloni duke pastruar dyert dhe dorezat e dyerve
  - Kontrolloni muret për njolla të dukshme dhe pastrojini ato

  - Pastroni çelësat e dritave
  - Pastroni të gjitha mobiljet dhe sipërfaqet horizontale në dhomë duke përfshirë karriget, parvazin e dritares, komodinën dhe tavolinat. Ngrijini objektet për të pastruar tavolinat. Kushtojini vëmendje të veçantë sipërfaqeve që preken me duar.
  - Pastroni me leckë të njomë pajisjet në mure si pompa e aspirimit, manometri i presionit të gjakut, dhe stativi i serumit
  - Pastroni gjithë pjesët e shtratit
  - Pastroni banjën/tualetin (shikoni procedurat për pastrimin e banjos)
  - Pastroni dyshemenë (shikoni procedurat për pastrimin e dyshemesë)
  - Hiqni dhe largoni mbetjet
  - Vendosni teshat e ndotura në kontenierin e veçantë për lavanderi
  - Kontrolloni kontenierin e mbeturinave dhe largoni mbeturinat. Zëvendësoni qesen me një të re.
- Hiqni dorezat dhe pastroni duart me ujë dhe sapun kur janë shumë të ndotura, ose me solucion xheli me përmbajtje alkooli.

MOS U LARGONI NGA DHOMA DUKE MBAJTUR DOREZA TË NDOTURA.

- Zëvendësoni pajisjet që kërkohen (psh sapun, leter tualeti)
- Pastroni duart me xhel

PASTRIM I PLANIFIKUAR I DHOMËS SË PACIENTIT

Përveç pastrimit të përditshëm të dhomave të pacientëve, duhet të programohet dhe pastrim shtesë:

- Marrja e pluhurave në sipërfaqet horizontale dhe objektet në lartësi, duke përfshirë aspiratorët (psh çdo javë)
- Pastrimi i këndeve dhe blinduseve të mureve (psh për javë)
- Pastrimi i perdeve/mbulesave të dritareve kur ndoten ose të paktën një herë në vit
- Marrja e pluhurave të grillave të dritave të paktën një herë në muaj

PASTRIMI I DHOMËS SË PACIENTIT QË DEL NGA SPITALI/ TRANSFEROHET

Kur një pacient largohet, transferohet, dhoma apo hapësira e shtratit të tij/saj duhet të pastrohet dhe dezinfektohet tërësisht përpara se një pacient tjetër të zërë të njëjtën hapësirë. Përgjegjësitë e personelit shëndetësor përfshijnë:

- Heqjen apo largimin e pajisjeve mjekësore
- Boshatisja e shisheve të aspirimit, largimi dhe hedhja e tubave dhe qeseve të serumit, hedhja e qeseve të mbledhjes së kateterit urinar, boshatisja e uturakëve
- Largimi i pajisjeve të terapisë së oksigjenit
- Largimi i të gjithë sendeve personale të lëna nga pacienti

Sapo punonjësi shëndetësor të ketë kryer këto detyra, pastrimi pas largimit nga spitali/transferimit mund të kryhet nga personeli i pastrimit.

PROCEDURA E PASTRIMIT TË DHOMËS SË PACIENTIT QË DEL/TRANFEROHET NGA SPITALI

- Vlerësimi
  - Kontrolloni për shenja kujdesi të veçanta (shiko procedurat e pastrimit për kujdes të veçantë)

  - Kaloni përmes dhomës për të përcaktuar çfarë ka nevojë të zëvendësohet (letra e tualetit, peshqiri, sapuni), të boshatiset koshi i mbeturinave, ose nëse kërkohet ndonjë material tjetër; kjo mund të bëhet përpara ose gjatë procesit të pastrimit

- Përgatitni pajisjet
  - Sigurohuni që ka furnizim të teshave të pastra
  - Përgatitni solucionin e dezinfektantit sipas udhëzimeve të prodhuesit
- Pastroni duart duke përdorur solucion xheli dhe vishni dorezat
- Ndërroni teshat e ndotura:
  - Hiqni mbulesat e shtratit (këllëf, çarçafë, batanije) dhe vendosini në qesen e teshave të ndotura; palosini me kujdes çarçafët për të parandaluar aerosolet
  - Hiqni dorezat dhe pastroni duart
- Aplikoni doreza të pastra dhe pastroni dhomën duke punuar nga zonat e pastra tek ato të ndotura dhe nga zonat e larta tek ato të poshtme të dhomës:
  - Filloni duke pastruar dyert dhe dorezat e dyerve
  - Kontrolloni muret për njolla të dukshme dhe pastrojini ato, hiqni adezivët nga muri dhe pastroni njollat
  - Pastroni çelësat e dritave
  - Pastroni të gjitha mobiljet dhe sipërfaqet horizontale në dhomë duke përfshirë karriget, parvazin e dritares, komodinën dhe tavolinat. Ngrijini objektet për të pastruar tavolinat. Kushtojini vëmendje të veçantë sipërfaqeve që preken shumë me duar
  - Pastroni pajisjet në mure (psh pompa e aspirimit, manometri i presionit të gjakut, stativi i serumit, dhe karroca me rrota)
  - Pastroni brenda dhe jashtë sirtareve të komodinës dhe dollapeve të pacientit
- Pastroni shtratin
  - Pastroni pjesën e sipërme dhe anët e dyshekut, kthejeni nga ana tjetër dhe pastroni dyshekun në pjesën e poshtme
  - Pastroni pjesën e sipërme të sustës së shtratit dhe kornizën e shtratit
  - Pastroni pjesën metalike të shtratit; kushtojini vëmendje të veçantë sipërfaqeve që preken më shumë me duar nga stafi
  - Pastroni të gjitha pjesët e poshtme të shtratit duke përfshirë këmbëzat apo rrotat
  - Lejo që të thahet dysheku
- Pastroni banjon (shiko procedurat për pastrimin e banjos)
- Pastroni dyshemenë (shiko procedurat për pastrimin e dyshemesë)
- Largimi i mbetjeve
  - Vendosni teshat e ndotura në kontenierin e veçantë për në lavanderi
  - Kontrolloni kontenierin e mbeturinave dhe largoni mbeturinat
  - Pastroni koshin e mbeturinave nëse është ndotur. Zëvendësoni qesen me një të re
- Hiqni dorezat dhe pastroni duart me ujë dhe sapun kur janë shumë të ndotura, ose me solucion

xheli me përmbajtje alkooli.

MOS U LARGONI NGA DHOMA DUKE MBAJTUR DOREZA TE NDOTURA.

- Rregulloni shtratin dhe zëvendësoni pajisjet që kërkohen (psh sapun, letër tualeti, letër duarsh, furçë tualeti)

PASTRIMI I TUALETEVE

Tualetet duhet të pastrohen të fundit pasi është përfunduar pastrimi i dhomës. Muret e dushit duhet të fërkohen tërësisht të paktën një herë në javë. Perdet e dushit duhet të ndërrohen shpesh.

Tualetet e dhomave të Urgjencës dhe tualetet e tjera që ndodhen në korridore dhe jo brenda dhomave të pacienteve mund të kontaminohen me lehtësi dhe nga viruse enterike si norovirusi. Si minimum, këto duhet:

- të pastrohen dhe dezinfektohen të paktën çdo katër orë
- preferohet të dezinfektohen me një agjent sporicidal
- të inspektohen shpesh dhe të ripastrohen nëse është e nevojshme
- të pastrohen më shpesh bazuar në nevojat

Pastrimi i tualeteve kërkon një monitorim periodik, i cili duhet të kryhet nga një supervizor që ndjek procedurën e pastrimit.

PROCEDURA PËR PASTRIMIN RUTINË TË BANJOVE.

- Hiqni teshat e ndotura nga dyshemeja; lani ndonjë derdhje; hiqni mbeturinat
- Ndërroni të gjithë qeset e mbeturinave, lani koshin nëse është ndotur
- Pastroni dorezën e derës, kornizën dhe çelësin e dritave
- Pastroni brenda dhe jashtë lavamanin, rubinetin e lavamanit dhe pasqyrën; lani tubat nën lavaman; aplikoni dezinfektant në pjesën e brendshme të lavamanit; lejoni për një kohë të mjaftueshme kontakti të dezinfektantit; shpëlani lavamanin dhe thani pjesët e palëvizshme
- Pastroni mbajtëset, parvazet, kornizat e murit
- Pastroni rubinetat e dushit, muret dhe kornizat duke i fërkuar sikurse kërkohet për të hequr shkumën e sapunit; aplikoni dezinfektant në hapësirën e brendshme të dushierit, duke përfshirë mbajtësen e sapunit, rubinetat dhe kokën e dushit, lejoni për një kohë të mjaftueshme kontakti të dezinfektantit, shpëlajeni dhe thajeni
- Pastroni të gjithë tualetin duke përfshirë pjesën e poshtme të shkarkuesit, duke lejuar për kohë të mjaftueshme kontakti të dezinfektantit
- Hiqni dorezat dhe lani duart
- Zëvendësoni letrën e tualetit, letrën e duarve, sapunin apo xhelin
- Raportoni për rrjedhje, çarje apo zona të dëmtuara në banjo që kanë nevojë për riparim

PASTRIMI I DYSHEMESË DHE KORRIDOREVE

Dyshemetë dhe korridoret në ambientet spitalore mund të kompromentohen nga një numër materialesh, në varësi të vendndodhjes së dyshemesë/korridorit dhe pacientët që janë në afërsi të saj/tyre.

Çështja nëse duhet të përdoret apo jo një dezinfektant në larjen rutinë të dyshemesë dhe korridoreve nuk është zgjidhur ende. Në rrethana normale, nuk kërkohet përdorimi i dezinfektantit por vetëm i detergjentit.

Pastrimi i dyshemesë bëhet me shtupë të thatë për heqjen e pluhurave dhe mbetjeve, e ndjekur nga pastrimi me shtupë të lagur me një detergjent për pastrim.

Pastrimi i thatë bëhet me shtupa ose lecka me mikrofibër për të zvogëluar përhapjen e pluhurave dhe mbetjeve. Një shtupë e re duhet të përdoret për çdo dhomë.

PROCEDURA PËR LARJEN E DYSHEMESË/KORRIDOREVE

Punohet nga zonat e pastra drejt zonave të ndotura:

- Përgatitet solucioni i pastrimit (detergjenti) sipas udhëzimeve të Protokollit Klinik për Kontrollin dhe Parandalimin e Infeksioneve Spitalore të ISHP-së dhe udhëzimeve të prodhuesit.
- Vendoset shtupa në solucionin e pastrimit të hedhur në kovë dhe shtrydhet.
- Pastrohet me shtupë duke filluar me fundin e murit, duke i kushtuar vëmendje pastrimit të qosheve; evitoni spërkatjen e mureve dhe mobiljeve.
- Në hapësirat e hapura përdorni tetë lëvizjet, duke kapërcyer çdo lëvizje; kthejeni shtupën me kokë poshtë pas çdo pesë apo gjashtë lëvizjesh.
- Lani një hapësirë tre metro me tre, dhe pastaj shpëlani dhe shtrydhni shtupën.
- Përsëriteni deri sa të pastrohet komplet dyshemeja.
- Ndërroni shtupën kur ndotet shumë ose në fund të ditës.
- Ndërroni vazhdimisht solucionin e pastrimit së bashku me ujin e kovës (për çdo katër dhoma pacientësh ose kur ndotet shumë).

PAJISJET E TRANSPORTIT.

Pajisjet e transportit (psh barrelat, karrocat, karriget me rrota) që përdoren nga më shumë se një pacient duhet të dezinfektohen me një dezinfektant spitalor menjëherë pas përdorimit dhe përpara përdorimit nga një pacient tjetër kur janë dukshëm të ndotura, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zonave që preken më shumë me duar (krahët e karriges, doreza e shtyrjes). Nëse mjeti i transportit mbulohet nga një çarçaf mbrojtës, nevoja për pastrim do të zvogëlohet vetëm në rastet kur është dukshëm i ndotur.

Si shtesë, të gjitha pajisjet e transportit duhet të pastrohen sipas një plani të caktuar. Përgjegjësia për pastrimin e pajisjeve të transportit duhet të përcaktohet qartë (psh personel mjekësor apo personel pastrimi).

Mjetet e përdorura për të transportuar një person të vetëm brenda godinës (karriget me rrota, karrocat) duhet të pastrohen menjëherë kur kontaminohen me gjak ose lëngje trupore, si dhe të kryhet pastrimi i tyre rutinë sipas një plani të shkruar.

Ambulancat (makinat që transportojnë pacientë në barrela) duhet të pastrohen, dezinfektohen dhe sistemohen pas transportit të çdo pacienti dhe një pastrim rrënjësor i rregullt dhe i planifikuar duhet të kryhet kur ka kontaminim të madh të ambulancës.

4.2.2 ZONAT STERILE/KIRURGJIKALE

SALLAT E OPERACIONIT

Pastrimi i ambienteve në sallat kirurgjikale minimizon ekspozimin e pacientëve dhe personelit ndaj mikroorganizmave infektive. Ka standarte të qarta për pastrimin e ambienteve në sallat kirurgjikale. Një skemë e rekomanduar nga ISHP në Protokollin Klinik për Kontrollin dhe Parandalimin e Infeksioneve Spitalore është:

- Çdo mëngjes para ndërhyrjeve: pastrim komplet i sallës me anë të një dezinfektanti të rekomanduar dhe pastrim i të gjitha sipërfaqeve horizontale

- Midis ndërhyrjeve: pastrim dhe dezinfektim i të gjitha sipërfaqeve dhe sendeve kirurgjikale (si psh tavolina, etj)
- Një herë në javë: pastrim komplet i Bllokut Operator me solucion dezinfektant (Hipoklorit, Formalinë, Chloraminë) përfshirë këtu të gjithë anekset si dhomën e veshjes, dhomën teknike, dhomën e rafteve, etj
- Një herë në tre muaj: bëhet marrja e mostrave nga të gjithë ambientet dhe materialet e përdorura në operacion e dokumentuar në një fletore të veçantë
- Në fund të ditës: bëhet pastrimi dhe dezinfektimi i sallës dhe vënia në gadishmëri e saj

HIGJIENA E PERSONELIT

- Para operimit personeli duhet të ndërrohet me rroba të pastra në dhomë të veçantë.
- Për të shmangur bartjen e mikroorganizmave patogjenë në sallën e operimit, rrobat e dedikuara për punë në sallë nuk duhet të barten jashtë sallës.
- Duhet të ndërrohen këpucët (galloshet) kur dilet nga salla e operacionit.
- Rrobat e operacionit të paketohen në qese të izoluara (po në Sallën e Operacionit).
- Ekipi operator duhet të bartë mantela dhe doreza sterile.

LARJA E DUARVE PARA OPERACIONIT (PASTRIMI KIRURGJIKAL I DUARVE).

- Hiqen bizhuteritë dhe ora.
- Përvishen mëngët deri në bërryl.
- Lahen duart dhe parakrahët.
- Përdoret ujë i rrjedhshëm i ngrohtë.
- Përdoret sapun, mundësisht antibakterial.
- Lani të gjitha sipërfaqet me kujdes, duke filluar nga kyçet, kurrizin e dorës, gishtat.
- Për sipërfaqen nën thonjtë mundësisht të përdoret furçë thonjsh kirurgjikale.
- Fërkohen duart me njëra-tjetrën deri në 10-15 minuta, me 0,5% chlorhexidinë glukonate, ose povidon - 70% jod, 60% izopropanol, ose 70% etanol.
- Të bëhet dezinfektimi me solucion betadinë 0,5% duke u ndihmuar nga një person tjetër.
- Me kompresë sterile fshihen duart që fillohet nga parakrahët, vazhdon me duart deri në mollëzat e gishtërinjve

Me kryerjen e këtyre procedurave, duart janë sterile.

PASTRIMI I INSTRUMENTAVE TË SALLES SË OPERACIONIT.

- Të gjitha instrumentet që përdoren në operacione duhet t'i nënshtrohen Dezinfektimit dhe më pas Sterilizimit
- Instrumentet e tjera të papërdorura përpara sterilizimit i nënshtrohen vetëm procesit të pastrimit.

PASTRIMI përfshin këto procese:

- Shpërlahen me ujë të rrjedhshëm për 30 sekonda me furçë kirurgjikale, instrumentet duhet fillimisht të zbërthehen në pjesët përbërëse të tyre, ky veprim kryhet në pavijon apo sallë operacioni pas përdorimit të tyre.
- Njomja me solucion larës, ky solucion përgatitet në një enë të madhe sipas numrit të instrumenteve,

këto instrumente futen në solucion dhe lihen për 15 minuta.

- Larja. në po këtë solucion instrumentet fërkohen me furçë për 1-2 minuta.
- Shpëlarja me ujë të rrjedhshëm të bollshëm çezme për 1-2 minuta, pastaj shpërlahen me ujë distile për 4-5 minuta.
- Tharja. instrumentet dhe tërë artikujt pas shpëlarjes thahen për eliminimin e plotë të lagështirës, për tharje përdoren aerosteril në 80°C.
- Paketimi, të tëra materialet pas larjes dhe tharjes duhet të paketohen, ku futen në kuti metalike, e cila gjatë kohës së sterilizimit është e hapur dhe menjëherë pas sterilizimit kapaku i kutisë mbyllet, afati i ruajtjes së instrumenteve me këtë mënyrë paketimi është brenda ditës.

TRANSPORTI I PAJISJEVE, APARATURAVE, INSTRUMENTAVE.

Pasi ka përfunduar procesi i sterilizimit dhe paketimit, instrumentat bëhen gati për transport. Instrumentat vendosen nëpër paketa të veçanta.

Gjatë transportit duhet siguruar mbrojtja e instrumenteve. Për këtë gjë janë të përshtatshme kontenitorët dhe makinat e mbylluara. Transporti nuk është i nevojshëm nëse dhoma ku bëhet sterilizimi i përgjithshëm është e lidhur direkt me sallën e operacionit, pra nëse kjo pjesë e dhomës së sterilizimit përdoret edhe si depo e instrumentave të sterilizuar.

Në rast nevoje, transporti dhe dorëzimi i instrumentave në vendin e duhur, duhet të kryhet përkatësisht sipas kërkesave higjienike. Në mjedise delikate, si salla e operacionit, pavionet e terapisë intensive, dorëzimi duhet të kryhet nëpërmjet sistemeve të rafteve të dorëzimit apo të ndarjeve të posaçme. Për instrumentat më të përdorshëm, pjesa e sterilizuar e dhomës së sterilizimit mund të lidhet direkt me sallën e operacionit.

PROCEDURA PËR PASTRIMIN E SALLAVE MIDIS OPERACIONEVE.

- Përgatitni solucion të freskët dezinfektanti sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe Protokollit të ISHP-së për Kontrollin dhe Parandalimin e Infeksioneve Spitalore.
- Pastroni duart dhe vendosni dorezat.
- Mblidhni dhe largoni mbetjet.
- Mblidhni dhe largoni të gjithë teshat e ndotura.
- Hiqni dorezat dhe lani duart.
- Përdorni një picetë të njomur në solucion dezinfektanti spitalor për të pastruar dhe dezinfektuar të gjithë sipërfaqet horizontale që kanë qënë në kontakt me pacientin apo lëngjet trupore, duke përfshirë pjesën e sipërme të dritave kirurgjikale, manshetat e presionit të gjakut, shgutin.
- Pastroni aspiratorin, pastroni dhe lani vazot.
- Pastroni dhe dezinfektoni shtratin.
- Pastroni pajisjet elektronike (psh monitorët) sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Lani me shtupë në një perimetër 1 me 1.3 metër hapësirën rreth shtratit (ose në një zonë më të gjerë nëse ka kontaminim të pranishëm); per çdo rast përdorni një shtupë të veçantë.
- Vendsoni qese të reja për mbetjet e buta.
- Pastroni me picetë të njomë pluhurat e aparaturave të tjera si cilindrat e gazit të kompresuar apo aparaturave të radiografisë përpara se të sillen në sallën e operacionit dhe përpara se të largohen nga salla.
- Kur pastrimi të jetë i plotë, hiqni dorezat dhe lani duart

PROCEDURË PËR PASTRIMIN E SALLAVE TË OPERACIONIT NË FUND TË DITËS

Për sallat e operacionit në të cilat punohet në mëngjes dhe mbasdite, pastrimi final duhet të kryhet në mëngjes përpara fillimit të punës dhe është pastrimi më i plotë.

PERSONELI INFERMIEROR:

- Pas përfundimit të ndërhyrjes kirurgjikale, personeli infermieror largon instrumentat dhe bën pastrimin dhe sterilizimin e tyre, largon dhe hedh materialet e buta të përdorura në kosha të veçantë, ndërsa teshat dërgohen në lavanderi.
- Pastrohen dhe dezinfektohen me shumë kujdes elektrobisturitë, diatermitë dhe kordonet e tyre me leckë të njomë.
- Aparati i anestezisë dhe pajisjet e tjera, psh monitor, kablli elektrik pastrohen dhe dezinfektohen me kujdes të veçantë sipas udhëzimeve të prodhuesit.

PERSONELI I PASTRIMIT:

- Përgatitni solucion të freskët dezinfektanti sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe Protokollit të ISHP-së për Kontrollin dhe Parandalimin e Infeksioneve Spitalore.
- Lani duart dhe vishni dorezat.
- Mblidhni dhe largoni mbetjet.
- Mblidhni dhe largoni të gjithë teshat e ndotura.
- Pastroni duart dhe ndërroni dorezat.
- Pastroni dhe dezinfektoni prozhektorët, dorezat dhe krahët e tyre dhe dritat e tjera të montuara në mur.
- Pastroni dhe dezinfektoni dorezat e dyerve, çelësat e dritave.
- Kontrolloni muret për shenja ndotjeje dhe pastrojini nëse ka.
- Pastroni dhe dezinfektoni të gjithë sipërfaqet e jashtme të pajisjeve (psh karroca e anestezisë) duke lejuar për një kohë të mjaftueshme për tharjen e dezinfektantit.
- Pastroni dhe dezinfektoni të gjithë mobiljet duke përfshirë rrotat.
- Pastroni dhe dezinfektoni pjesën e jashtme të kabineteve, dyerve, veçanërisht rreth dorezave të tyre.
- Pastroni dhe dezinfektoni të gjithë sipërfaqet horizontale.
- Pastroni duke fërkuar lavamanet dhe muret rreth tyre.
- Pandoflat prej gome pastrohen dhe më pas dezinfektohen me dezinfektant Chloramine.
- Lani dyshemene me shtupë, sigurojuni që të lëvizet shtrati dhe të lahet dyshemeja poshtë tij; zhvendosni të gjitha mobiljet në qendër të dhomës dhe vazhdoni të pastroni dyshemene; aplikoni një sasi të mjaftueshme dezinfektanti/detergjenti për të siguruar që dyshemeja të mbetet e lagur për 5 minuta; përdorni një shtupë të re dhe solucion të freskët për çdo sallë operacioni.
- Rivendosni të gjithë pajisjet dhe mobiljet në vendin e duhur.
- Pastroni me lecke të njomë kontenierët e mbetjeve, thajini tërësisht dhe rivendosini.
- Raportoni për çdo riparim të nevojshëm.
- Pastroni dhe magazinoni pajisjet e pastrimit.

- Hiqni dorezat dhe lani duart.

Përveç pastrimit të përshkruar në procedurat e mësipërme mund të kryhet dhe pastrim shtesë i planifikuar. Tabela më poshtë tregon se si mund të planifikohet pastrimi shtesë i objekteve në bllokun operator.

PASTRIM I PLANIFIKUAR PËR SALLAT E OPERACIONIT

Objektet për tu pastruar	Shpeshtësia
Tavanet, duke përshirë kondicionerët, aparaturat e ventilimit dhe neonet	Çdo muaj
Muret, duke përfshirë dyert dhe dritaret	Çdo javë
Dyshemetë, duke përfshirë qoshet, këndet, blindusat	Çdo javë
Dhomat dhe hapësirat e magazinimit	Çdo muaj
Sipërfaqet e jashtme të pajisjeve dhe makinerive	Çdo javë
Mobiljet, duke përshirë karrocat/rrotat e tyre	Çdo javë
Sterilizuesit, kabinetet (brenda dhe jashtë)	Çdo javë
Të gjithë sipërfaqet horizontale (duke përfshirë dollapet, etj)	Çdo javë
Dhomat e mjekut, infermieria, dhomat e zhveshjes	Çdo ditë

4.2.3 PROCEDURË PËR PASTRIMIN E AMBIENTEVE TË LABORATORIT KLINIK

STAFI I LABORATORIT:

- Minimizoni magazinimin e materialeve që nuk i përkasin punës suaj dhe që nuk mund të dekontaminohen me lehtësi (psh, libra, revista, korrespodencë, etj)
- Veshjet e Laboratorit nuk duhet të vendosen në kontakt me veshjet që përdoren jashtë pune.
- Veshjet e kontaminuara duhet të dekontaminohen përpara se të çohen në lavanderi.
- Pastroni dhe dekontaminoni sipërfaqet e punës me një dezinfektant spitalor në fund të ditës dhe pas çdo derdhje materiali potencialisht të rrezikshëm.
- Zëvendësoni dhe riparoni sipërfaqet e punës që janë bërë të përshkrueshme për materialet e rrezikshme (çarë, thyer, humbur).

STAFI I PASTRIMIT:

- Largoni mbetjet, duke përfshirë mbetjet biomjekësore dhe kontenierët e mbushur të sendeve të mprehta.
- Zëvendësoni sapunin, letrën e duarve, dhe flakonin e xhelit me alkool nëse janë mbaruar.
- Pastroni lavamanët e larjes së duarve.
- Lani dyshemenë me shtupë.
- Pastroni çdo javë abazhuret, raftet, tavolinat, dollapet, karriget, radiatorët dhe çdo mobilje apo pajisje tjetër të laboratorit.

4.2.4 PROCEDURA E PASTRIMIT TË SALLAVE TË LINDJES NË MATERNITET

Salla e lindjes pastrohet me detergjent dhe sipërfaqet të cilat mund të kenë kontakt me lëndë biologjike (gjak, sputum, vomitus, feçe, urinë) përveç pastrimit me detergjent, dezinfektohen me solucione dezinfektantë në varësi të stokut të lindjes. Salla e lindjes pastrohet menjëherë gjatë lindjes, por vetëm me detergjent, nëse në sipërfaqet e caktuara derdhet material biologjik.

PASTRIMI I SALLËS SË LINDJES PAS LINDJES (PASI LEHONA TRANSFEROHET NË PAVION)

- Lahen me detergjent shtrati, shtrati obstetrikal, tavolina e instrumentave dhe të gjitha sipërfaqet e tjera
- Pasi thahet, sipërfaqja e dyshemesë lahet përsëri me solucion dezinfektant spitalor (psh Bacillol) 175ml i tretur në 5 litra ujë
- Para sterilizimit, pajisjet mjekësore të përdorura për lindje dezinfektohen me Endoplival, në varësi të udhëzuesit të prodhuesit
- Të gjitha orenditë e sallës së lindjes që mund të kontaminohen me likide biologjike, duhet të dezinfektohen me solucion Endoplival dhe të lahen me detergjent të zakonshëm pasi të kenë qëndruar të lagura nga solucioni i mësipërm për 3 orë
- Sanitarja thirret nga mamia e sallës së lindjes për të pastruar materialin biologjik të derdhur apo për të mbajtur pastër dhe thatë shtratin e gruas në aktivitet lindjeje në çdo moment gjatë lindjes
- Sanitarja nuk qëndron asnjëherë më gjatë se sa duhet në sallën e lindjes
- Përgjegjësi për të gjithë procedurën e pastrimit dhe dezinfektimit të sallës së lindjes mban mamia e sallës së lindjes e cila dorëzon me shkrim të pastruar dhe detoksikuar sallën e lindjes

PASTRIMI I PAVIONIT ROOMING-IN

- Dhomat e pavionit rooming-in duhet të lahen me detergjent të zakonshëm 1 herë në 24 orë
- Çdo 3 orë dyshemeja dhe mobiljet pastrohen me ujë të pastër
- Çdo 2 ditë dhe sa herë që dhomat janë bosh, dezinfektohen dhe detoksikohen të gjitha sipërfaqet me solucionet e mësipërme (krevatet me Endoplival dhe dyshemeja dhe sipërfaqet e tjera me Bacillol)
- Sa herë derdhet material biologjik, ai pastohet menjëherë nga personeli i pastrimit të pavionit
- Koshat e mbetjeve të zakonshme zbrazen çdo 4 orë dhe gjithmonë kur kërkohet nga mamitë e pavionit apo pacientët e shtruara

PASTRIMI I KORRIDOREVE TË REPARTIT TË OBSTETRIKËS (ROOMING-IN, PATOLOGJIA E SHTATZANISË)

- Korridoret e repartit të Obstetrikës lahen me detergjent të zakonshëm çdo 3 orë
- Korridoret dezinfektohen 1 herë në tre ditë me solucion Bacillol

PASTRIMI I BANJAVE TË REPARTIT TË OBSTETRIKËS

- Banjat e repartit të Obstetrikës lahen me detergjent të zakonshëm çdo 2 orë
- Banjat e repartit dezinfektohen me solucion Bacillol çdo 12 orë

NJESITË E KUJDESIT INTENSIV DHE DHOMAT E NEONATËVE

Pastrim i përditshëm rutinë në njësitë e terapisë intensive për neonatet duhet të kryhet duke ndjekur të njëjtën procedurë si për dhomat e pacientëve të rritur.

Inkubatori dhe pajisjet në afërsi të tij që kanë lidhje me neonatin konsiderohen si ambient i pacientit. Produktet e përdorura për pastrimin dhe dezinfektimin e dhomave të neonatëve dhe njësisë së terapisë intensive për fëmijët nuk duhet të jenë toksike (psh fenolina nuk duhet të përdoret).

Zonat e përgatitjes së qumështit mund të kontaminohen dhe duhet të pastrohen nga personeli i pastrimit pas çdo përgatitje dhe në çdo turn.

PASTRIM RUTINË I AMBIENTIT TË INKUBATORIT

Personeli infermieror:

- Hiqni tubat e gazit mjekësor dhe pajisje të tjera të jashtme nga inkubatori
- Hiqni pajisjet mjekësore nga brenda inkubatorit dhe i dezinfektoni

Personeli i pastrimit:

MOS PERDORNI DEZINFEKTANTE FENOLIKE

- Kontrolloni për objekte brenda inkubatorit, duke përfshirë të mprehtat
- Hiqni të gjithë artikujt që mund të ndodhen brenda inkubatorit
- Hiqni adezivët nga xhami me alkool, pastaj lajeni
- Pastroni dhe dezinfektoni xhamin
- Hiqni të gjithë pjesët e lëvizshme nga brenda inkubatorit, pastroni dhe dezinfektoni, duke lejuar për një kohë të mjaftueshme kontakti të dezinfektantit
- Pastroni plotësisht jashtë inkubatorit, duke përfshirë rrotat
- Ri-lani xhamin me një leckë të pastër të njomur në ujë për të hequr çdo mbetje të dezinfektantit
- Rivendosni pjesët në inkubator
- Mbuloni inkubatorin me një batanije fëmijësh, dhe shënoni datën e pastrimit

PROCEDURA PËR PASTRIMIN E NJËSISË SË TERAPISË INTENSIVE PËR TË RRITUR

- Kryhet fillimisht mbledhja dhe largimi i mbetjeve (urbane dhe të rrezikshme spitalore)
- Pastrohen koshat dhe vendosen qese të pastra në to dhe kjo përsëritet sa herë nevojitet
- Ndalohet pastrimi me shtupë të thatë, lejohet vetëm me të njomë
- Shtupa ndërrohet pas çdo pastrimi dhome/boksi dhe në fund të turnit
- Pajisjet higjienike pastrohen çdo mëngjes dhe pasdite sa herë të jetë e nevojshme
- Pastrimi kryhet në mëngjes, pasdite dhe sa herë të jetë e nevojshme për dhomat e personelit të njësisë së terapisë intensive
- Muret në kushte normale duhet të lahen një herë në javë ose sa herë që ndoten
- Tavanet, dritat, fletet e kondicionerëve, aspiratorëve pastrohen një herë në muaj ose më shpesh kur janë të ndotur
- Xhamat dhe parvazet e dritareve nga ana e brendshme pastohen një herë në javë ose kur janë të ndotur
- Xhamat në dyert e hyrjes për në boksin e pacientit pastrohen dy herë në ditë

4.3 PASTRIMI DHE DEZINFEKTIMI I AMBIENTEVE TË PACIENTËVE NË PËRKUJDESJE TË VEÇANTË

Përveç pastrimit rutinë, praktika të pastrimit shtesë dhe/ose përdorimi i mjeteve mbrojtëse personale për pastrim (doreza, maskë, përparëse) mund të kërkohet nën rrethana të veçanta.

Dhomat nën përkujdesje të veçantë duhet të kenë shumë pak pajisje. Përpara hyrjes në dhomë, pajisjet e pastrimit duhet të përgatiten përpara aplikimit të mjeteve mbrojtëse personale. Mjetet mbrojtëse personale duhet të hiqen, të vendosen në koshin e duhur dhe duart duhet të pastrohen përpara se të kalohet në një dhomë tjetër apo të kryhet një detyrë tjetër. Mjetet mbrojtëse personale nuk duhet të vishen jashtë dhomës së pacientit apo hapësirës së shtratit.

PASTRIMI I DHOMAVE/ BOKSEVE TË PACIENTËVE NË MASA PËRKUJDESI KONTAKTI

Pastrimi i dhomave të pacientëve kur një individ është në përkujdesje kontakti kërkon shtimin e një mjeti mbrojtës personal, si dhe disa procedura shtesë për pacientët me sëmundje infektive ngjitëse. I gjithë stafi i pastrimit që hyn në dhomën e këtyre pacientëve duhet të veshë përparëse dhe doreza dhe duhet t'i heqë ato dhe të kryejë higjienën e duarve përpara largimit nga dhoma.

Duhet të lihet kohë e mjaftueshme për pastrimin dhe dezinfektimin e dhomave të pacientëve me sëmundje infektive ngjitëse.

PASTRIMI RUTINË I AMBIENTEVE TË PERSONAVE ME SËMUNDJE INFEKTIVE NGJITËSE

Protokolle të rrepta duhet të zbatohen për pastrimin dhe dezinfektimin e përditshëm të dhomave të pacientëve me sëmundje infektive ngjitëse.

Këshillohet që pastrimi dhe dezinfektimi i ambienteve të personave me sëmundje infektive ngjitëse të bëhet dy herë në turn.

Një nga faktorët më të rëndësishëm në pastrimin e këtyre ambienteve është evitimi i kontaminimit të tërthortë. Kjo aplikohet duke përdorur pajisje dhe materiale të veçanta pastrimi/dezinfektimi për çdo dhomë dhe të evitohet ripërdorimi i leckave të pastrimit.

Mjetet e transportit dhe pajisjet ose sipërfaqet të cilat kanë qënë në kontakt të drejtpërdrejtë ose jo të drejpërdrejtë me pacientin e infektuar me sëmundje infektive ngjitëse ose që është duke kryer një procedurë mjekësore, diagnostike ose kirurgjikale në një repart tjetër, duhet të pastrohen dhe dezinfektohen menjëherë pasi pacienti largohet, duke ndjekur Protokollin Klinik për Parandalimin dhe Kontrollin e Infeksioneve Spitalore të publikuar nga ISHP.

PASTRIMI KUR PACIENTI DEL NGA SPITALI/TRANFEROHET

Kërkesa të veçanta përfshijnë:

- Do të ketë një proces që të sigurojë që pastrimi dhe dezinfektimi i dhomave është bërë në mënyrën e duhur kur pacienti del apo transferohet nga spitali. Kjo do të sigurohet nëpërmjet inspektimit nga supervizori i punonjësve të pastrimit pas kryerjes së pastrimit.
- Materiale dhe pajisje të veçanta duhet të përdoren për çdo dhomë pacienti me sëmundje infektive ngjitëse (leckë, shtupë, kovë, piceta) si për pastrimin e përditshëm ashtu dhe për pastrimin pas daljes nga spitali/transferimin.
- Leckat e pastrimit nuk duhet të ripërdoren (përdorni një leckë vetëm një herë të vetme dhe mos e zhysni përsëri në solucionin e pastrimit).
- Nuk kërkohen masa të veçanta për pastrimin e teshave.

PROCEDURA PËR PASTRIMIN E DHOMAVE TË PACIENTËVE ME SËMUNDJE INFEKTIVE NGJITËSE

Pastrimi i përditshëm - të pastrohet dy herë në turn

Përveç procedurës së përdorur në pastrimin rutinë të dhomave dhe tualeteve duhet të:

- Përdoret kovë dhe shtupë e veçantë për çdo dhomë dhe për çdo tualet (dhe vetëm për atë dhomë dhe tualet).
- Pas pastrimit, të aplikohet një dezinfektant (preferohet sporicidal) në të gjithë sipërfaqet e dhomës dhe të tualetit dhe të lejohet kohë e mjaftueshme kontakti e dezinfektantit sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Të bëhet dy herë në turn pastrimi dhe dezinfektimi i dhomës dhe tualetit të pacientit.

PROCEDURA E PASTRIMIT PAS DALJES NGA SPITALI/TRANFERIMIT PËR PACIENTIN ME SËMUNDJE INFEKTIVE NGJITËSE – PASTRIM I PËRGJITHSHËM

Përveç procedurës për pastrimin rutinë të dhomave/tualeteve të pacientëve që dalin nga spitali/transferohen duhet të:

- Largohen të gjithë objektet e ndotura/të përdorura (psh kontenieri i aspirimit, objektet me një përdorim).
- Hidhni të gjithë objektet e mëposhtme: sapun, letër tualeti, letër duarsh, furça e tualetit.
- Përdorni lecka, shtupa, materiale dhe solucione të veçanta për të pastruar dhomën.
- Përdorni disa lecka për të pastuar dhomën. Përdorni çdo leckë vetëm një herë të vetme. Mos e lagni përsëri në dezinfektant pas përdorimit për ta ripërdorur për një sipërfaqe tjetër. MOS I RIPËRDORNI LECKAT.
- Pastroni dhe dezinfektoni të gjitha sipërfaqet dhe lejoni për një kohë të mjaftueshme kontakti me dezinfektantin.

5. PASTRIMI I NJOLLAVE TË GJAKUT DHE SUBSTANCAVE TË TJERA TRUPORE

Njollat e gjakut dhe substancat e tjera trupore, të tilla si urina, feçet, dhe të vjellat, duhet të kufizohen, të pastrohen dhe të dezinfektohen menjëherë.

Politikat dhe procedurat që kanë të bëjnë me njollat biologjike përfshijnë:

- Sigurimin e personelit të duhur dhe të trajnuar dhe mjeteve të duhura për pastrimin e njollave biologjike gjatë gjithë kohës
- Një metodë për kufizimin dhe izolimin e njollës
- Akses ndaj mjeteve personale mbrojtëse (doreza, maskë, përparëse) dhe pajisjeve të tjera
- Largimin e duhur të mbetjeve
- Dokumentim të incidentit të njollës/derdhjes

PROTOKOLL PËR PASTRIMIN DHE DEZINFEKTIMIN E NJOLLËS SË GJAKUT DHE SUBSTANCA TË TJERA TRUPORE

- Përgatitni materialet që nevojiten për pastrimin e njollës përpara se të vishni mjetet mbrojtëse personale.
- Inspektoni plotësisht zonën rreth njollës për spërkla apo njolla të tjera.
- Kufizoni aktivitetin rreth njollës deri në momentin që zona të jetë pastruar dhe dezinfektuar dhe të jetë plotësisht e thatë.
- Vishni dorezat, nëse ka mundësi spërkatje, vishni një përparëse dhe një mbrojtje faciale (maskë dhe syze mbrojtëse).
- Kufizoni njollën; fshini menjëherë çdo njollë gjaku ose lëngu trupor qoftë duke përdorur një peshqir/picetë me një përdorim ose një produkt të përcaktuar për këtë qëllim. Hidhni materialet duke i vendosur në koshat e zakonshëm të hedhjes së mbeturinave, por në qoftë se materialet e ndotura janë shumë të laguara me gjak, në këtë rast ato duhet të hidhen në kontenierin e mbetjeve biomjekësore (psh qese e verdhë).
- Dezinfektoni të gjithë zonën e njollës me një dezinfektant spitalor dhe lejoni një kohë të caktuar kontakti të rekomanduar nga prodhuesi.
- Fshini përsëri zonën duke përdorur peshqir apo picetë me një përdorim dhe hidheni në koshin e zakonshëm.
- Duhet të tregohet kujdes për të evituar spërkatjen apo gjenerimin e aerosoleve gjatë pastrimit.
- Hiqni dorezat dhe kryeni higjienën e duarve.

6. PROCEDURA PËR PASTRIMIN E MAKINËS SË AMBULANCËS

PASTRIM RUTINË PAS ÇDO TRANSPORTI:

- Vendosni mbetjet biomjekësore (psh, fashot, garzat, çarçafët e kontaminuar dhe batanijet që janë të ndotura me gjak) në një kontenier të mbetjeve të materialeve bio të rrezikshme
- Largoni me kujdes materialet e mprehta që gjenden gjatë pastrimit në kontenierin e caktuar të sendeve të mprehta
- Largoni teshat/batanijet e përdorura për në lavanderi
- Pastroni dhe dezinfektoni/sterilizoni pajisjet e përdorura për një emergjencë
- Pastroni dhe dezinfektoni kabinën dhe vendin e pacientit sikurse kërkohet
- Nëse ambulanca është shumë e kontaminuar do të nxirret jashtë shërbimit dhe të pastrohet rrënjësisht

PASTRIM RRËNJËSOR KUR KËRKOHET DHE KUR PLANIFIKOHET:

Vendi i Shoferit

- Largoni të gjithë pajisjet nga pjesa e përparme e makinës
- Pastroni dyshemenë me fshesë me avull
- Pastroni dhe dezinfektoni të gjithë sipërfaqet e brendshme, duke përfshirë muret, dyert, pajisjet e radios, kroskotin dhe dritaret

Vendi i pacientit

- Lëvizni barrelat, pastroni dhe dezinfektoni dyshekun dhe rripat, kontrolloni për dëmtime apo çarje
- Lëvizni pompën e aspirimit, pastrojeni dhe dezinfektojeni
- Largoni përmbajtjet e dollapeve dhe rafteve, pastroni dhe dezinfektoni të gjithë sipërfaqet
- Pastroni, dezinfektoni dhe thani të gjithë objektet me sipërfaqe të fortë përpara se të kthehen në dollap apo raft; inspektoni për dëmtime apo data skadimi; riparoni/zëvendësoni sa herë nevojitet
- Fshini me fshesë me avull, pastroni dhe dezinfektoni dyshemenë
- Pastroni dhe dezinfektoni karriget, stolat, dhe rripat e sigurimit
- Pastroni dhe dezinfektoni të gjithë sipërfaqet e brendshme, duke përfshirë tavanin dhe muret
- Kontrolloni ndriçimin e brendshëm
- Boshatisni, pastroni dhe dezinfektoni kontenierët e mbeturinave
- Pastroni dritaret e brendshme

Vendi i mbajtjes së pajisjeve

- Hiqni pajisjet dhe pastroni vendin
- Pastroni dhe dezinfektoni vendin dhe rivendosni pajisjet

7. PROTOKOLL MBI HIGJIENËN OPTIMALE TË DUARVE

Për larjen e duarve duhet:

- Ujë i rrjedhshëm
- Produktet e duhura: sapun ose antiseptik në varësi të procedurës
- Mjetet e duhura të pa-kontaminuara për fshirjen dhe tharjen e duarve

Për dezinfektimin e duarve: Dezinfektantë specifik

Kur duhet të lahen duart:

- Kur mjekojmë apo kryejmë manipulime të vogla
- Kur ndihmojmë, pastrojmë dhe rregullojmë pacientin në krevat
- Para marrjes së ushqimit
- Para dhe pas shfrytëzimit të tualetit
- Para kryerjes së procedurave invazive
- Para dhe pas punimit të plagëve, kateterave urinare dhe pajisjeve të tjera
- Para dhe pas mbartjes së dorezave
- Pas kontaktit me të sëmurë që janë të kolonizuar me mikroorganizma patogjene spitalore

Teknikat e larjes së duarve

Procedurat e thjeshta të higjienës kufizohen vetëm për duart dhe kyçin e dorës dhe ato kirurgjikale duhet të përfshijnë duart dhe parakrahun.

Procedurat ndryshojnë në varësi të vlerësimit të riskut.

Kujdesi Rutinë

- Higjiena e duarve me sapun jo dezinfektantë ose
- Dezinfektim higjienik i shpejtë i duarve me solucion alkoolik
- Pastrim antiseptik i duarve- kujdes aseptik i pacientëve të infektuar
- Higjiena e duarve me sapun antiseptik (duke ndjekur instruksionet e prodhuesit (p.sh.: 1 minutë)
- Ose higjienë e shpejtë dezinfektuese: si më parë

Përmbledhje e çështjeve kyçe lidhur me higjienën e duarve

- Duart duhet të dekontaminohen menjëherë para dhe pas çdo kontakti direkt me pacientin dhe pas çdo situate që mund të rezultojë me kontaminim të tyre.
- Duart të cilat janë dukshëm të ndotura ose të kontaminuara me materiale organike duhet të lahen me ujë dhe sapun.
- Në rastet kur duart nuk janë dukshëm të pista, preferohet që duart të dekontaminohen me një solucion me përmbajtje alkooli para se të kalohet nga një pacient tek tjetri dhe midis dy aktiviteteve të ndryshme tek i njëjti pacient.
- Përpara se të filloj pastrimi i duarve, duhet që të hiqen të gjitha bizhuteritë që mbahen në dorë.

Thonjtë duhet të mbahen të shkurtër, të pastër dhe pa manikyr.

- Që pastrimi i duarve të jetë i efektshëm duhen ndjekur 3 hapat e mëposhtme: përgatitja, larja, shpëlarja, dhe tharja e duarve. Përgatitja kërkon që duart të lagen me ujë të vakët përpara se të aplikohet sapuni i lëngshëm ose ndonjë preparat anti-mikrobik. Solucioni që përdoret duhet të ketë kontakt me çdo pjesë të sipërfaqes së dorës. Duart duhet të fërkohen mirë për rreth 10-15 sekonda, duke u siguruar që janë pastruar dhe majat e gishtërinjve, gishtat e mëdhenj dhe zonat midis gishtërinjve. Duart duhet të shpëlahen me ujë të bollshëm përpara se të thahen me letra të një kualiteti të mirë.
- Kur duart pastrohen me anë të një solucioni me përmbajtje alkooli, ato nuk duhet të kenë ndotje të dukshme ose materiale organike. Solucioni duhet të prekë të gjithë sipërfaqen e dorës. Duart duhet të fërkohen mirë deri sa solucioni të avullojë, duke u siguruar që janë pastruar siç duhet dhe majat e gishtërinjve, gishtat e mëdhenj dhe zonat midis gishtërinjve.
- Një krem zbutës duhet të përdoret rregullisht për të mbrojtur lëkurën nga tharja që mund të shkaktojë larja e shpeshtë e duarve.

Për të pakësuar transmetimin e mikroorganizmave nëpërmjet ambientit dhe pajisjeve duhet të zbatohen metodat e dezinfektimit dhe sterilizimit.

8. DEZINFEKTIMI DHE STERILIZIMI

8.1 DEZINFEKTIMI

Dezinfektimi është proces i zvogëlimit të numrit të mikroorganizmave patogjenë, por jo i sporeve të baktereve, nga objektet e ndryshme apo nga lëkura, deri në atë shkallë që nuk e dëmton shëndetin.

Dezinfektimi largon mikroorganizmat pa sterilizim të plotë për të ulur kështu transmetimin e mikroorganizmave ndërmjet pacientëve.

Instrumentet pas operacioneve purulente, operacioneve tek të sëmurët me sëmundje ngjitëse si dhe sistemet e transfuzionit që përdoren tek të sëmurët me sëmundje ngjitëse, veçanërisht me hepatit B, (në repartet apo spitalet infektive), është e nevojshme që para pastrimit t'i nënshtrohen dezinfektimit.

Të gjitha pajisjet kirurgjikale duhet të zhyten në solucion Kloraminë 0,5% për 30 minuta, ose detergjent, pra në 1 litër ujë të hidhet 5 gr Kloraminë ose detergjent.

Në përdorimin e një dezinfektanti duhet të ndiqen dhe rekomandimet e përdoruesit.

Produkte dhe procese të ndryshme sigurojnë nivele të ndryshme dezinfektimi.

Dezinfektantët janë klasifikuar si të fortë - me nivel mesatar- ose me nivel të ulët dezinfektimi.

- Dezinfektim me nivel të lartë (kritik) - Kjo shkatërron të gjithë mikroorganizmat me përjashtim të kontaminimit të lartë me spore bakteriale.
- Dezinfektim mesatar (gjysëmkritik) - Kjo inaktivizon mykobakterium tuberkulosis, bakteret vegjetative, shumicën e viruseve dhe myqeve (fungi) por nuk vret sporet bakteriale.
- Dezinfektim i nivelit të ulët (jo kritik) - Mund të vrasë shumicën e baktereve, disa viruse, dhe disa myke por nuk është i aftë për të vrarë baktere rezistente si M. Tuberkulosis, ose sporet bakteriale.
- Këto nivele të dezinfektimit arrihen duke përdorur produktet kimike të përshtatshme në mënyrën e duhur dhe për nivelin e duhur të dezinfektimit.

DEZINFEKTIMI I APARATURAVE MJEKËSORE-TEKNIKE

Të gjitha pjesët e aparateve që janë në kontakt direkt apo indirekt me pacientët, duhet patjetër të pastrohen. Ato duhet të jenë edhe të dezinfektueshme gjë që mund të realizohet me: dezinfektim termik (90°C/min), dezinfektim kimik.

Nëse këto pjesë të aparaturave nuk kanë vetëm kontakt sipërfaqësor, por edhe me gjakun, me të brendshmet e trupit, etj, atëherë këto pjesë duhet me çdo kusht të sterilizohen.

Edhe pjeset e tjera të këtyre aparateve mjekësore, të cilat nuk janë në kontakt direkt me njerëzit (mjekët apo pacientët) duhet të pastrohen.

DEZINFEKTIMI I ENDOSKOPIT SI NJË NGA PAJISJET INVAZIVE MË TË PËRDORSHME

Sterilizimi i Endoskopit si instrument invaziv minimal dhe pajisjeve të tjera aksesore të ngjashme është i nevojshëm por është i vështirë për arsye të strukturës së ndërlikuar të ndërtimit të këtyre instrumenteve.

Për të ulur transmetimin e infeksioneve spitalore nëpërmjet endoskopit duhet të zbatohet një procedurë standarde sistematike.

HAPAT:

- Menjëherë pas përdorimit duhet të pastrohet kanali i ajrit dhe ujit duke pompuar me forcë ajër dhe ujë ose detergjente në kanalin e biopsisë dhe më pas aspirim për të larguar mbeturinat organike.

- Të gjitha pjesët e ndashme (kapakët dhe valvulat) duhet të hiqen dhe të futen në një enë me solucion pastrues dhe pjesa e jashtme e endoskopit duhet të fshihet me kujdes.
- Të gjitha pjesët e arritshme duhet të shpëlahen me ujë të rrjedhshëm ose solucion pastrues, (duke përdorur një furçë sterile ose një përdorimshe).
- Pas pastrimit mekanik endoskopi duhet të dezinfektohet qoftë mekanikisht qoftë automatikisht. Në të dyja rastet procesi i plotë përfshin disa hapa.
- Pastrimi duke përdorur një detergjent pastrues të aprovuar në të cilin zhysim endoskopin (ky detergjent nuk duhet të ripërdoret). Para zhytjes në solucion endoskopi duhet të testohet për ndonjë dëmtim.
- Shpëlarje dhe fshirje e pajisjes (ujë i rrjedhshëm është i mjaftueshëm në këtë fazë).
- Dezinfektimi duke përdorur një dezinfektant të aprovuar të nivelit të lartë.
- Procedura dhe kohëzgjatja është sipas llojit të dezinfektantit që do të përdoret.
- Përsa i përket riskut të sëmundjes së Creutzfeldt-Jakob (CJD) nuk duhet të përdoret një dezinfektant që ka aftësi fiksuese të proteinave. Duhet të zgjidhet një dezinfektant jo fiksues i proteinave.
- Shpëlarja: Niveli i pastërtisë bakteriale të ujit të përdorur për shpëlarje do të varet nga përdorimi i mëtejshëm i endoskopit (ujë i kontrolluar bakteriologjikisht ose i sterilizuar).
- Tharja: Nëse endoskopi do të përdoret përsëri kjo fazë duhet të përfshijë vetëm tharjen me anë të futjes së ajrit për të larguar ujin e mbetur.

DEZINFEKTIMI I SHTRETËRVE

- Është kusht elementar i higjienës spitalore që çdo pacient që shtrihet në një krevat të pastër t'i garantohet siguria e mosmarrjes së mikrobeve të pacientit paraardhës.
- Çarçafët dhe këllëfët si dhe mbulesat në dhomën e të sëmurit duhet të ndërrohen gjithmonë dhe mundësisht duke eliminuar krijimin e pluhurit.
- Teshat e palara duhet të vendosen në thasë të trashë dhe të çohen në lavanderi.
- Vetë shtrati (armatura e tij) dezinfektohet.
- Sfungjerët dhe leckat e përdorura për këtë qëllim, pas përdorimit lahen dhe dezinfektohen ose hidhen kur janë shumë të dëmtuara. Ruajtja e tyre bëhet vetëm kur ato janë të thata.
- Dyshekët duhen dezinfektuar, nëse kanë mbulesa mbrojtëse atëherë bëhet dezinfektimi i këtyre të fundit.

PËRZGJEDHJA E NJË DEZINFEKTANTI

Zgjedhja e një dezinfektanti varet nga faktorë të ndryshëm, ndër të cilët:

- Niveli i kërkuar i dezinfektimit (i lartë, i mesëm, i ulët);
- Lloji i mikroorganizmave - Rezistenca ndaj dezinfektantëve varet sipas llojit të mikroorganizmit: Një dezinfektant aktiv kundër baktereve mund të mos jetë efikas kundër viruseve dhe fungjeve.

NJË SUBSTANCË DEZINFEKTUESE DUHET TË PËRMBUSHË KRITERET:

- Të shkrihet shpejt dhe plotësisht në ujë, duke formuar përzierje të qëndrueshme,
- Të mbysë mikrobet në përqendrime të vogla dhe në afate sa më të shkurtra,

- Të tregojë efekt të mirë edhe në prani të substancave organike,
- Mos të humbasë vetitë baktericide dhe veti të tjera dezinfektuese gjatë ruajtjes.

8.2 STERILIZIMI

Sterilizimi është procedurë e shkatërrimit të të gjithë mikroorganizmave të gjallë, përfshirë edhe sporet e baktereve.

METODAT KRYESORE TË STERILIZIMIT:

Sterilizimi Termal

- Sterilizim i Njomë: Ekspozim ndaj avujve të lagësht në temp 121°C për 30 min ose 134°C për 13 minuta në autoklavë
- Sterilizim i thatë: Ekspozim në 160°C për 120 minuta ose 170°C për 60 minuta; ky sterilizim konsiderohet më pak i sigurtë se metoda e parë veçanërisht për disa pajisje me shumë tuba, gropa, etj...

Sterilizimi Kimik

- Oksidi i Etilenit dhe Formaldehida janë nxjerrë nga përdorimi për arsye të sigurisë në lidhje me emetimin e gazrave.
- Acidi Paracetik përdoret gjerësisht në proceset e sistemit automatik të sterilizimit.

9. MENAXHIMI I TESHAVE TË NDOTURA

Të gjithë teshat që janë të ndotura me gjak, lëngje trupore, sekrecione dhe ekskrecione duhet të menaxhohen duke përdorur të njëjtat përkujdesje:

- Hiqni ndotjet e shumta (psh feçet) me dorezë dhe hidhini në tualet. Mos largoni ekskrementet duke i spërkatur me ujë.
- Vendosni në qese teshat e kontaminuara për t'i çuar në lavanderi.
- Mos i përzgjidhni apo të para-lani teshat e kontaminuara në zonat e kujdesit shëndetësor.
- Vendosini në qese objektet/teshat personale të ndara nga teshat e tjera në pikën e grumbullimit.
- Menaxhoni teshat e kontaminuara me qetësinë më të madhe për të evituar kontaminimin e ajrit, sipërfaqeve dhe njerëzve (psh palosini).
- Vendosni teshat e laguara në një çarçaf apo peshqir të thatë përpara se t'i vendosni në qesen përkatëse.
- Karrocat e rrobave që përdoren për të mbledhur dhe transportuar teshat e ndotura nuk ka nevojë të jenë të mbuluara. Ato duhet të lahen rregullisht.
- Qeset e teshave duhet të lidhen në mënyrë të sigurt dhe nuk duhet të jenë të tejmbushura.
- Praktikat e larjes rutinë të teshave janë të përshtatshme për të gjithë llojet e tyre, pavarësisht nga burimi.

Nuk kërkohet menaxhim i veçantë për pacientët nën përkujdesje të veçantë.

TESHAT E PASTRA

Duhet të ketë zona të përcaktura për përzgjedhjen, paketimin (nëse kërkohet) dhe magazinimin e teshave të pastra. Teshat e pastra nga lavanderia nëpër reparte duhet të transportohen dhe magazinohen në një mënyrë që parandalon menaxhimin e pakujdesshëm ose kontaminimin e tyre nga pluhuri apo pjesëzat e tjera të ajrit. Çdo kat i spitalit ku ofrohet kujdes shëndetësor duhet të ketë një zonë të caktuar (psh dollap të veçantë, dhomë furnizimi të pastër) për magazinimin e teshave të pastra. Nëse përdoret një sistem me karroca të mbyllura, vendosja e karrocave të teshave të pastra në një qoshe/kthinë lejohet vetëm në rastin kur kjo është jashtë rrugës së trafikut normal dhe nën kontrollin e stafit.

10. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Asgjësimi i mbeturinave të shfrytëzueshme kryhet nëpërmjet sistemeve të asgjësimit komunal (depozitimi, kompostimi, djegia).

Mbeturinat që mund të trajtohen në të njëjtën mënyrë si mbeturinat e shtëpisë dhe sipas mundësisë dhe mund të riciklohen.

MBETURINAT E NGJASHME ME MBETURINAT E SHTËPISË

- Ambalazhet (kartonet, etj)
- Letrat (gazetat, etj)
- Porcelani, qelqi
- Tekstilet
- Mbeturinat e kuzhinës

Mbeturinat të cilat paraqesin rrezik infeksioni dhe plagosjeje, por që nuk duhet të mënjanohen si mbeturina të rrezikshme.

- Fashot e plagëve, fashot e allçive, panolinat, artikujt me një përdorim (garza, doreza, shiringa, katetere, aparatet e serumit, qeset e serumeve) edhe nëse këto janë me gjak.
- Enët e lartpërmendura duhet të boshatisen; plazma, tretësirat e serumeve, gjaku dhe urina duhet të trajtohen si mbeturina, të cilat kalojnë jashtë me shkarkimet e ujrave.
- Nëse enët me lëngje nuk boshatisen, atëherë ato duhet të asgjësohen si mbeturina të rrezikshme, meqënëse nuk lejohet depozitimi i mbeturinave të lëngshme.
- Aget e serumeve dhe objektet e tjera me majë ose të mprehta që janë të rrezikshme për plagosje si: pincetat, skarpelet, dhe mbeturinat e ampulave.
- Të gjitha mbeturinat me majë apo të rrezikshme për plagosje duhet të futen në kuti të sigurta. Ato duhet të grumbullohen në enë (kuti) të forta që nuk i depërtojnë lëngjet dhe që mbyllen mirë.

ASGJËSIMI I GJILPËRAVE:

- Të hidhen direkt pas përdorimit në kosh të paderpërtueshëm nga aget
- Të mos vihen përsëri këllëfët e sigurisë së ageve
- Të mos ndahen nga shiringat

Mbeturinat të cilat paraqesin një rrezik brenda dhe jashtë spitalit kërkojnë në të dy rastet një trajtim të veçantë:

- Kulturat mikrobiologjike jo të dezinfektuara
- Mbeturinat e ngarkuara me mikrobe të rrezikshme; përveç kësaj mbeturinat që dalin nga trajtimi i personave me sëmundje shumë infektuese
- Mbeturina të tjera në sektorin mjekësor

Pjese të trupit dhe mbeturina organesh duhet të çohen në Laboratorin Anatomo-Patologjik dhe prej aty të dorëzohen tek vendi i asgjësimit (groposjes). Nëse ato nuk groposen, duhet të digjen në një aparaturë të veçantë. Në këtë kategori duhet të futen edhe qeset e mbushura me gjak dhe ato të gjakut të konservuar, të cilat duhet të digjen.

Për pjesët e trupit dhe mbeturinat e organeve duhen pasur parasysh ligjet përkatëse të groposjes së kufomave dhe duhet të merren parasysh edhe rregullat për përpunimin e trupit të kafshëve.

MBETURINAT E ILAÇEVE

Potenciali i rrezikshmërisë së ilaçeve mund të kuptohet nga përbërja e tyre (e shënuar në ambalazh).

Mbeturinat e ndotura me substanca citostatike (psh fashot, sistemet e tubave, tamponet e thithjes, përparëset me një përdorim, dorezat, fshirëset) duhet të vendosen në kuti të veçanta dhe të mbyllura mirë. Ampulat me përqëndrime të larta ose mbeturinat e medikamenteve pluhur duhet të asgjësohen si mbeturina të rrezikshme. Kjo vlen dhe për mbetjet dhe shishet e serumeve më të mëdha se 150 ml.

Koshat që përdoren për grumbullimin e të gjitha mbeturinave duhet të jenë të përshtatshëm për secilin grup mbeturinash dhe t'i përgjigjen këtyre kritereve:

- Të jenë të padepërtueshëm nga lëngjet
- Të mbyllen fort dhe mirë
- Të mos jenë transparente
- Të jenë të sigurt gjatë transportit
- Të jenë rezistente ndaj shpimit apo çarjes (për mbeturinat e sendeve të mprehta apo ampulat dhe flakonet)

Kur kontenieri i mbetjeve parësore biomjekësore është një kontenier i sendeve të mprehta ose një kontenier i fortë me një kapak të palëvizshëm, paketim shtesë për transportin e mbetjeve jashtë reparteve nuk është i nevojshëm. Nëse kontenieri parësor është një qese plastike (bidon plastik), qesja duhet të vendoset në një kontenier të fortë, pa çarje, dëmtime, rrjedhje për transportimin e mbetjeve jashtë reparteve për në vendin e grumbullimit.

TRANSPORTI I MBETJEVE

Të gjithë mbetjet do të transportohen brenda spitalit duke përfshirë procedurat e mëposhtme:

- Ka rrugë transporti qartësisht të përcaktuara për mbetjet
- Të minimizohet menaxhimi manual i mbetjeve
- Rrugët e transportit të mbetjeve evitojnë kalimin përmes zonave të pastra, njësive të kujdesit për pacientin apo zonave publike
- Një ashensor i veçantë caktohet për transportin e mbetjeve. Në repartet ku nuk ka një ashensor, mbetjet nuk duhet të transportohen në të njëjtën kohë me lëvizjen e pacientëve, karrocat e shpërndarjes së ushqimit apo të teshave të pastra/ instrumentave/pajisjeve sterile.
- Mbetjet transportohen në karroca pa të çara, rrjedhje apo dëmtime dhe pastrohen rregullisht.
- I gjithë transporti i jashtëm i mbetjeve bëhet në përputhje me VKM nr 798, datë 29.09.2010 për miratimin e rregullores "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore".

11. LISTËKONTROLLET PËR PASTRIMIN MJEDISOR DHE INSTRUMENTAT E MONITORIMIT

LISTËKONTROLLI

Përdorimi i listave të kontrollit nga stafi i pastrimit do të sigurojë që të gjitha etapat e procedurave të pastrimit janë ndjekur dhe do të lejojë gjithashtu për vetë-vlerësim dhe përmirësim të punës së personelit të pastrimit. Në listëkontrollet janë përfshirë të gjithë hapat që përmban procesi i pastrimit.

Listëkontrolli e pastrimit #1 është një listëkontrolli që përdoret për pastrimin e përditshëm rutinë të dhomave dhe ambienteve të pacientit.

Listëkontrolli e pastrimit #2 është një listëkontrolli që përdoret për pastrimin e dhomës dhe ambienteve të pacientit me sëmundje infektive ngjitëse kur del nga spitali apo transferohet.

11.1 LISTËKONTROLLI PASTRIMI #1: PASTRIM I PËRDITSHËM RUTINË I DHOMËS SË PACIENTIT:

☐Kontrolloni për shenja përkujdesjeje të veçanta dhe ndiqni me kujdes udhëzimet

☐Ecni përmes dhomës për të përcaktuar se çfarë duhet të zëvendësohet

☐Sigurohuni që ka një sasi të mjaftueshme picetash të pastra të disponueshme

☐Përgatitni dezinfektantin sipas udhëzimeve të prodhuesit

☐Pastroni duart duke përdorur xhel dhe vishni dorezat

☐Pastroni dyert, dorezat e dyerve, dhe zonat që preken të derës

☐Kontrolloni muret për shenja ndotjeje dhe pastrojini ato

☐Pastroni çelësat e dritave dhe termostatet

☐Pastroni të gjithe objektet e montuara në mur

☐Kontrolloni dhe hiqni njollat e gishtave dhe papastërtitë nga pjesët e brendshme të paneleve të derës dhe pjesës prej xhami, pasqyrës dhe dritareve, me ilaç pastrues për xhamat

☐Pastroni të gjithë mobiljet dhe sipërfaqet horizontale duke përshirë:

- karriget
- parmakun e dritares
- tavolinat dhe komodinat

☐Fshini me leckë të njomë me dezinfektant pajisjet në mur si aspiratorin, manometrin e presionit arterial, stativin e serumit

☐Pastroni kokën e krevatit dhe të gjithë anët e tij

☐Pastroni banjon/dushierin

☐Pastroni lavamanin dhe WC-në

☐Pastroni dyshemene

☐Vendosni leckat e ndotura në kontenierin e teshave të lavanderisë

☐Kontrolloni koshin e mbeturinave dhe hidhni mbeturinat

☐Vendosni mbeturinat e dukshme në koshin e mbeturinave

☐Hiqni dorezat dhe pastroni duart

☐Zëvendësoni pajisjet që duhen (letra e duarve, letra e tualetit, sapun, etj)

☐Pastroni duart me xhel dhe dilni nga dhoma

11.2 LISTËKONTROLLI PASTRIMI #2: PASTRIMI I DHOMËS SË PACIENTIT NË PËRKUJDESJE TË VEÇANTË PËR SËMUNDJE INFEKTIVE NGJITËSE

☐Përdorni një kovë, leckë, dhe shtupë të pastër. Përdorni çdo leckë vetëm një herë. MOS RIPËRDORNI LECKAT

☐Përgatitni dezinfektant sporicidal sipas udhëzimeve të prodhuesit

☐Pastroni duart duke përdorur xhel me bazë alkooli dhe vishni dorezat

☐Hiqni të gjithë objektet e ndotura/të përdorura (psh pompat e aspiratorit, objektet me një përdorim)

☐Hiqni teshat e ndotura (çarçafë, peshqir); palosini me kujdes çarçafët për të parandaluar aerosolet

☐Hidhni sapunin, letrën e duarve dhe letrën e tualetit

☐Hidhni dorezat, pastroni duart dhe vishni doreza të pastra

☐Pastroni dhe dezinfektoni të gjithë sipërfaqet e mëposhtme dhe lejoni për një kohë kontakti të përshtatshme të dezinfektantit:

- dyert, dorezat e dyerve, zonat që preken të kornizave të dyerve
- muret, nëse janë dukshëm të ndotura; hiqni adezivët nga muret
- çelësat e dritave dhe termostatet

☐Objektet e montuara në mur

☐Panelet e dyerve veçanërisht pjesën e xhamit, pasqyrat dhe dritaret

☐Karriget

☐Tavolinat (duke përfshire komodinën)

☐Parmakun e dritares

☐Lodrat, lojrat e ndryshme (reparti i pediatrisë)

☐Karrigen me rrota apo patericat nëse janë përdorur

☐Monitoret

☐Stativin e serumit dhe pompën

☐Pjesët e brendshme dhe të jashtme të dollapit apo sirtareve të të sëmurit

☐Pastoni shtratin:

- Kontrolloni për çarje apo vrima në dyshek dhe ndërrojini ata nëse është e nevojshme
- Pastroni objektet e mëposhtme, duke lejuar për një kohë të përshtatshme kontakti të dezinfektantit:
  - pjesën e sipërme dhe anët e dyshekut, kthejeni përmbys dhe pastroni pjesën e poshtme
  - pjesët e ekspozuara të sustës, anët e shtratit, duke përfshirë këmbëzat
  - kokën e shtratit dhe anët e tij

☐Lejoni që të thahet dysheku

☐Pastroni banjon/dushierin (shiko procedurën për pastrimin e banjos)

- Te hidhet furça e tualetit

☐Pastroni dyshemenë (shiko procedurat për pastrimin e dyshemesë)

☐Hedhja e mbeturinave:

- hidhni dhe zëvendësoni qesen e koshit të mbeturinave
- hidhni mbeturinat

☐Hiqni dorezat dhe pastroni duart

- Ribëni shtratin
- Zëvendësoni pajisjet:
  - sapunin
  - letrën e tualetit
  - letrën e duarve
  - furçën e tualetit

☐Ktheni pajisjet e ndotura (psh stativin e serumit, pompat, patericat, karrigen me rrota) për tu pastruar në dhomën e magazinës

12. INSTRUMENTAT E MONITORIMIT

Instrumentat e monitorimit përdoren nga supervizorët dhe menaxherët e personelit të pastrimit, stafi i trajnuar dhe të tjerët e përfshirë në procesin e përmirësimit të cilësisë të lidhur me pastrimin e ambienteve të kujdesit për pacientin.

KOHA E KËRKUAR

Monitorimet duhet të kryhen herë pas here për të lejuar për vëzhgime të mjaftueshme të praktikës së pastrimit. Koha që kjo do të marrë varet nga personat e shtruar dhe shifrat e shfrytëzimit të shtratit.

Më poshtë paraqitet një instrument monitorimi për pastrimin e përditshëm rutinë të dhomës së pacientit. ed Compliance Deficiency Note

INSTRUMENT MONITORIMI PËR PASTRIMIN E PËRDITSHËM TË DHOMËS SË PACIENTIT DHE AMBIENTEVE TË TJERA TË PAVIONIT

Zona e monitoruar	Pajtueshmëria			Mangësi të konstatuara
	Po	Jo	N/A	
Pajisjet				
Ka furnizim të mjaftueshem me letër higjienike, letër për duart, sapun apo xhel				
Kontenieri i mbeturinave është boshatisur				
Mbeturinat dhe teshat e ndotura janë hequr				
Pastrimi i sipërfaqeve				
Dyert, doreza e derës, kornizat				
Muret (ndotje të dukshme)				
Butonat e dritave, termostatet				
Objektet e montuara në mur				
Panelet e dyerve, pasqyrat dhe dritaret				
Karriget				
Parmaku i dritareve				
Tavolinat dhe komodina				
Pjesa e sipërme e pompës së aspirimit				
Manometri i presionit të gjakut				
Stativi i serumit				
Koka dhe korniza e shtratit				
Pajisjet e lëvizshme (psh patericat,				

karriget me rrota)				
Kontenieri i teshave (të gjitha sipërfaqet e tij)				
Pastrimi i banjos				
Pasqyra				
Kornizat, pajisjet e montuara në muret e banjos				
Mbajtëset mbështetëse				
Dorezat e derës dhe pjesët e tjera të derës				
Butonat e dritave				
Parvazet, raftet				
Lavamani dhe rubinetat				
Dushieri duke përfshirë rubinetat, kokën e dushit, mbajtësen e sapunit, finon				
WC-në duke përfshirë kapakun e sipërm dhe pjesën e brendshme të ndenjëses dhe kasetën				
Pastrimi i dyshemesë				
Dyshemeja e dhomës				
Korridoret				
Banjot e pavionit				
Dhomat e personelit (Infermieria, Dhoma e Mjekut)				
Dhoma e magazinës				
Pikët e pajtueshmërisë				
Numri total i "Po"-ve				Pikët e Pajtueshmërisë:
Numri total i "Jo"-ve				
Numri total i njësive ("Po"-të dhe "Jo"-të)				

13. STRUKTURA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE MJEDISORE DHE PËRSHKRIMET E PUNËS.

Hyrje

Në këtë manual paraqitet organizimi i Sektorit të Shërbimit Mjedisor Spitalor, strukturës organizative, qëllimi dhe objektivat e shërbimit si edhe mjetet e proçedurat e ndjekura për sigurimin e kushteve të higjienës dhe pastërtisë në spital.

Vizioni i Shërbimit

Mjedisi i pastër dhe i sigurtë në Spitalin Rajonal të Korçës është baza e parandalimit të infeksioneve spitalore, e krijimit të besimit për kujdesin ndaj pacientëve dhe njëkohësisht është baza e rritjes të sigurisë të personelit në spital. Shërbimi i kujdesit mjedisor, siguron një mjedis të shëndetshëm dhe estetik.

Misioni

Sektori i Shërbimeve Mjedisore synon krijimin e kushteve të përshtatshme higjienike dhe estetike në ambientet e brendshme dhe të jashtme të Spitalit. Në bazë të punës të këtij Sektori do të jetë zbatimi dhe monitorimi i vazhdueshëm dhe rigoroz i Standarteve dhe Praktikave të Pastrimit në Spitalin Rajonal Korçë.

Parandalimi i Infeksioneve Spitalore për pacientët, mbrojtja dhe siguria e pacientëve dhe personelit të Spitalit janë synim madhor për shërbimin Spitalor. Në këtë drejtim, vëmendja ndaj kujdesit mjedisor, synon të respektojë përparësinë që ka parandalimi ndaj trajtimit.

Sektori i Shërbimeve Mjedisore mbështetet dhe bashkëpunon ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Infeksioneve Spitalore i cili aprovon Manualin e Standarteve dhe Praktikave të Pastrimit dhe të Dezinfektimit.

13.1 STRUKTURA DHE DETYRAT E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE MJEDISORE.

13.1.1 STRUKTURA

- Ky sektor është organizuar si pjesë e strukurës administrative te spitalit nën varësinë e Nëndrejtorit Ekonomik
- Përgjegjës i Sektorit
- Specialist Monitorimi i Sektorit të Shërbimeve Mjedisore
- Punonjës i Shërbimit Mjedisor

13.1.2 DETYRAT E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE MJEDISORE.

- Monitoron dhe vlerëson punën e stafit të Shërbimeve Mjedisore.
- Koordinon punën me kryeinfermierët e Shërbimeve dhe sektorin e Hotelerisë për të realizuar cilësi të lartë të shërbimit.
- Vlerëson e programon nevojat për mjete dhe pajisje për sektorin e shërbimeve mjedisore.
- Vlerëson aftësitë profesionale dhe mundëson organizimin e trajnimeve për stafin e Sektorit të

Shërbimeve Mjedisore.

- Përgatit dhe aprovon pranë Komitetit të Parandalimit të Infeksioneve Spitalore Manualin e Standarteve dhe Praktikave të Pastrimit dhe të Dezinfektimit.
- Në raste të nevojshme bashkërendon punën dhe bashkëpunon me Njësinë e Kontrollit e Infeksioneve Spitalore me qëllim sigurimin e një ambienti të sigurt në Spital.

SPITALI RAJONAL KORÇË

PËRSHKRIM I PUNËS

1. TITULLI I PROFESIONIT: Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mjedisore

2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME: Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mjedisore administron Sektorin e Shërbimeve Mjedisore duke siguruar që standardet/parimet dhe procedurat sanitare dhe të pastrimit në spital të funksionojnë dhe zbatohen gjithmonë.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITE THEMELORE:

1. Siguron funksionimin dhe realizimin e aktivitetetit të Sektorit të Shërbimeve Mjedisore duke pasur si udhërrëfyes Manualin e Praktikave të Pastrimit dhe Dezinfektimit te Spitalit Rajonal Korce.
2. Organizon punën për përgatitjen e Manualit të Praktikave të Pastrimit dhe Dezinfektimit dhe e dërgon për aprovim pranë Komitetit të Kontrollit të Infeksioneve.
3. Monitoron dhe siguron zbatimin e manualit, politikave dhe procedurave që rregullojnë veprimtarinë e Sektorit të Shërbimeve Mjedisore.
4. Zhvillon dhe zbaton plane pune për Shërbimet Mjedisore.
5. Inspekton rregullisht punë të përfunduara dhe plotëson raporte të menaxhimit të cilësisë. Rekomandon metoda të reja për të përmirësuar performancën e përgjithshme.
6. Përgatit listën e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme dhe buxhetin e duhur për Sektorin e Shërbimeve Mjedisore dhe monitoron përdorimin e tyre.
7. Asiston në rekrutimin dhe punësimin e punonjësve. Ndihmon në orientimin, trajnimin dhe kualifikimin në vazhdim të punonjësve, dhe plotëson formularët dhe raportet e kërkuara në mënyrë të saktë dhe në kohë.
8. Vlerëson performancën e punonjësve dhe zbaton aktivitetet e përmirësimit të performancës. Takohet me punonjësit për të vlerësuar nevojat e zhvillimit profesional.
9. Planifikon, koordinon dhe integron shërbimet e ofruara nga Shërbimet Mjedisore me sektoret e tjerë të Spitalit.
10. Koordinon, drejton dhe merr pjesë në aktivitete të përmirësimit të performancës për Shërbimet Mjedisore.
11. Ka një plan periodik të shkruar ku pasqyrohen në detaje aktivitetet vjetore.
12. Zhvillon dhe mban marrëdhënie profesionale nëpërmjet sistemeve të komunikimit formal dhe informal duke përfshirë takimet dhe raportet verbale dhe të shkruara.

4. DETYRA DHE PËRGJEGJËSI TË TJERA:

- Tregon gadishmëri për t'iu përgjigjur detyrës dhe përgjegjësive që rrjedhin prej saj, duke përmbushur vazhdimisht standartet në punë.
- Koordinon punën e të gjithë sektorit që ka në varësi për të maksimizuar rezultatet në punë.
- Vepron në përputhje me të gjitha politikat dhe procedurat e spitalit.

5. KËRKESAT MINIMALE

Aftësitë dhe zotësitë e kërkuara:

- Të zotërojë aftësi menaxheriale dhe administrative.
- Të jetë i aftë për marrjen e vendimeve të sakta dhe në kohën e duhur.
- Të njohë aftësitë teknike të personelit në vartësi të tij/saj dhe të ndihmojë në aftësimin e tyre në vazhdimësi.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera në komunikim, në punën e ekipit dhe individuale.

Arsimimi dhe përvoja minimale:

- Diplomë universiteti.
- Diploma dhe certifikata të kurseve të tjera në funksion të detyrës.

Kërkesa Fizike: Në këtë pozicion mund të punojë çdo person i cili zotëron njohuritë, aftësitë dhe eksperiencën sipas vlerësimit të përgjithshëm. Kërkohet përdorimi i duarve dhe qëndrimi në këmbë për një kohë të gjatë.

6. KUSHTET E PUNËS

Procesi i punës zhvillohet në një mjedis të ndriçuar i cili ofron mundësitë për kryerjen optimale të punës. Gjithashtu, një ambient konkurues ndihmon në zhvillimin e aftësive personale dhe në rritjen e rendimentit të punës.

7. MBIKQYRJA E KRYER NGA:

- Nëndrejtori Ekonomik i Spitalit

8. DETYRAT MBIKQYRËSE:

- Mbikqyr performancën e personelit të Sektorit në varësi të tij/saj.

Une kam lexuar, kuptuar dhe pranuar përshkrimin e mësipërm të detyrave dhe përgjegjësive të cilat mund të rriten herë pas here bazuar në nevojat apo kërkesat e Spitalit. Ky përshkrim i punës nuk përbën një kontratë të shkruar apo nënkuptuar punësimi.

_____ _____

Firma e Punonjësit Data

Kjo është për të vërtetuar se detyrat dhe përgjegjësitë e mësiperme janë diskutuar dhe rishikuar me personin që mban detyrën.

_____ _____

Supervizori Data

SPITALI RAJONAL KORÇË

PËRSHKRIM I PUNËS

1. TITULLI I PROFESIONIT: Specialist/e Monitorimi e Sektorit të Shërbimeve Mjedisore

2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME: Mbikqyr aktivitetin e Punonjësve të Shërbimit Mjedisor gjatë procesit të pastrimit dhe sigurimit të higjienës në spital, duke njohur standardet, parimet dhe procedurat e vendosura dhe të miratuara nga Komiteti i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore për higjienën në spital dhe Sektori i Shërbimeve Mjedisore, me qëllim sigurimin e një shërbimi të plotë pastrimi dhe higjiene në përputhje me këto standarde dhe procedura.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË THEMELORE:

1. Mbikqyr punën e *Punonjësve të Shërbimit Mjedisor* duke siguruar që punonjësit i njohin dhe zbatojnë detyrat e tyre, Manualin e Praktikave të Pastrimit dhe Dezinfektimit dhe e kryejnë punën në përputhje me standardet e kërkuara dhe të miratuara duke siguruar dhe mbajtur një standard të lartë të pastërtisë dhe higjienës në ambientet spitalore.
2. Monitoron punën e *Punonjësve të Shërbimit Mjedisor* dhe plotëson periodikisht formën respektive të monitorimit.
3. Siguron zbatimin e plotë të procedurave si pastrim dhe fshirje të pluhurave, larje e kateve, zbrazje koshash të mbeturinave, pastrim i WC-ve etj në realizimin e standardeve të pastrimit dhe higjienës.
4. Menaxhon materialet e pastrimit dhe u siguron *Punonjësve të Shërbimit Mjedisor*, sipas nevojave që paraqesin, furnizimin përkates për kryerjen sa më të mirë të detyrave që mbulojnë.
5. Mban të informuar herë pas here ekipin e *Punonjësve të Shërbimit Mjedisor* në lidhje me objektivat aktuale dhe ato të rejat që mund të kërkohen për sigurimin dhe ruajtjen e standardeve të higjienës.
6. Bashkëpunon me ekipin e *Punonjësve të Shërbimit Mjedisor* në realizimin e objektivave dhe jep ndihmën e tij/saj në zgjidhjen e vështirësive që mund të hasen në punë e sipër nga ekipi i tyre.
7. Raporton tek Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mjedisore në lidhje me problemet që dalin gjatë supervizimit, me qëllim marrjen sa më të shpejtë të masave për zgjidhjen e tyre.

4. DETYRA DHE PËRGJEGJËSI TË TJERA:

- Tregon gadishmëri për t'iu përgjigjur detyrës dhe përgjegjësive që rrjedhin prej saj, duke përmbushur vazhdimisht standardet në punë.
- Vepron në përputhje me të gjitha politikat dhe procedurat e spitalit.

5. KËRKESAT MINIMALE

Aftësitë dhe zotësitë e kërkuara:

- Të zotërojë aftësi supervizuese dhe monitoruese.
- Të jetë i/e aftë për marrjen e vendimeve të sakta dhe në kohën e duhur.

- Të njohë aftësitë teknike të personelit në vartësi të tij/saj dhe të ndihmojë në aftësimin e tyre në vazhdimësi.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera në komunikim, në punën e ekipit dhe individuale.

Arsimimi dhe përvoja minimale:

- Të ketë arsimin minimal të detyruar sipas rregullores së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
- Të ketë një përvojë pune në sektorin e higjienës minimalisht 2 (dy) vjet, përvojë kjo e përfituar duke shërbyer në shërbime të ndryshme spitalore (minimumi në tre shërbime të ndryshme).
- Të ketë marrë pjesë në mënyrë aktive në trajnime të ndryshme të organizuara nga spitali apo institucione të tjera shëndetësore ku si objekt i tyre të ketë qënë arritja, sigurimi dhe mbajtja e standardeve të larta të higjienës në ambientet spitalore, kjo e vërtetuar me certifikata përkatëse apo dokumente zyrtare të lëshuara për këtë qëllim.

Kërkesa Fizike: Në këtë pozicion mund të punojë çdo person i cili zotëron njohuritë, aftësitë dhe eksperiencën sipas vlerësimit të përgjithshëm. Kërkohet përdorimi i duarve dhe qëndrimi në këmbë për një kohë të gjatë.

Kushtet e Punës: Proçesi i punës zhvillohet në një mjedis të ndriçuar i cili ofron mundësitë për kryerjen optimale të punës.

6. MBIKQYRJA E KRYER NGA:

- Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mjedisore.

7. DETYRAT MBIKQYRËSE:

- Mbikqyr performancën e personelit në vartësi të tij/saj.

SPITALI RAJONAL KORÇË

PËRSHKRIM I PUNËS

1. TITULLI I PROFESIONIT: Punonjës/e e Shërbimit Mjedisor

2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME:

- Punonjësi/a e Shërbimit Mjedisor të Spitalit përgjigjet për sigurimin e higjienës dhe pastërtisë të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Spitalit duke respektuar Manualin Praktikave të Pastrimit dhe Dezinfektimit të Spitalit.
- Punonjësi/a e Shërbimit Mjedisor mirëmban të gjitha pajisjet e pavionit sikurse janë: aparaturat e ndryshme, shtretërit, dhe materialet e tjera ndihmëse të pavionit.
- Punonjësi/a e Shërbimit Mjedisor përgjigjet dhe për rregullin dhe qetësinë në pavion. Kur konstaton grumbullime vizitorësh njofton K/infermieren apo infermieren e turnit.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË THEMELORE:

1. Pastron dhe lan të gjitha ambientet e repartit, dhomat e të sëmurëve, komodinat, dritaret, muret, korridoret, etj. Bën pastrimin dhe larjen e banjove sa herë që është e nevojshme.
2. Grumbullon dhe largon mbeturinat nga reparti nëpërmjet rrugëkalimeve të caktuara për këtë qëllim dhe i çon mbetjet e rrezikshme spitalore në hidroklav kurse mbetjet e tjera shkojnë ne qendrën e grumbullimit të mbetjeve spitalore.
3. Bën dizinfektimin e ambienteve, banjove, etj.
4. Përgjigjet për humbjet dhe dëmtimet e repartit në turnin e saj.
5. Komunikon me të sëmurët dhe familjarët vetëm për problemet që lidhen me punën e saj.
6. Ndihmon infermierët, kur është e nevojshme, për të sëmurët rëndë për kryerjen e nevojshme të tyre fiziologjike në shtrat ose i shoqëron ato për në tualet, së bashku me infermieren.
7. Njeh dhe zbaton Manualin e Praktikave të Pastrimit dhe Dezinfektimit dhe procedurat e pastrimit në Spital.
8. Për çdo problem që konstaton vë në dijeni K/infermieren e pavionit, infermieren e turnit dhe Specialisten Monitoruese të Sektorit të Shërbimeve Mjedisore.

4. DETYRA DHE PËRGJEGJËSI TË TJERA:

- Tregon gadishmëri për t'iu përgjigjur detyrës dhe përgjegjësive që rrjedhin prej saj, duke përmbushur vazhdimisht Manualin e Praktikave të Pastrimit dhe Dezinfektimit të Spitalit.
- I përmbahet Kodit të Sjelljes të Spitalit, duke respektuar etikën në lidhje me paraqitjen e jashtme.
- Mirëmban mjetet e pastrimit.

5. AFTËSITË DHE ZOTËSITË E KËRKUARA:

- Tregon aftësi të mira komunikuese me publikun dhe stafin e spitalit.

- Të jetë e ndershme dhe e besueshme.
- Të jetë fleksibël dhe e sjellshme.
- Të demonstrojë etikë të lartë në punë.

Arsimimi dhe përvoja minimale:

- Diplomë shkolle të nivelit të detyrueshëm arsimor.
- Të ketë përvojë pune.

6. KUSHTET E PUNËS:

Kërkesat fizike: Punonjësi/a e Shërbimit Mjedisor do të duhet të kalojë orë të gjata të qëndrimit në këmbë. Gjithashtu mund të kërkohet që herë pas here të mbajë dhe largojë koshat e mbeturinave.

7. MBIKQYRJA E KRYER NGA:

- Specialisti/a Monitoruese e Sektorit të Shërbimeve Mjedisore
- K/infermier/e i pavionit
- Shefi i Shërbimit